



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 43 regjistër (JR)
Datë 18.09.2019

Nr. 36 i vendimit
Datë 16.12.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.12.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonći Petković, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 43/2019 (JR), datë 18.09.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Cena, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 160, datë 14.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 49, 51, 52, 59, pika 1, 62, 63, pika 1, 65 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi shkaqet e ankimit

të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Cena (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Cena”. Më datë 19.12.2018, DSIK-ja solli raportin e përditësuar për subjektin e rivlerësimit, sipas të cilit Grupi i Punës rishikon konstatimin fillestar të

¹ Raporti i ILDKPKI-së, nr. {***} prot., datë 22.01.2018.

² Raporti i parë i DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.11.2017, ka vlerësuar përshtatshmërinë për vijimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, dhe me raportin e rishikuar nr. {***} prot., datë 19.12.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit nr. {***}, datë 08.01.2019, sipas të cilit është vlerësuar për papërshtatshmërinë për vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit.

kontrollit të figurës nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

5. KLP-ja ka hartuar raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Ky raport është bazuar: në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; në 5 dosjet hetimore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; në të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe analizoi të dhënat në 8 dosjet, referuar neneve 71 – 76 për kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 160, datë 14.06.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 e 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/c dhe pikës 3 të nenit 58 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*
8. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kriterëve të vlerësuar.

8.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit: i) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë nr. 1 të vendimit të Komisionit, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie; ii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për aktmarrëveshjen siguroese të trajtuar në pikën 3 të vendimit të Komisionit; iii) ka njohur dhe pranuar dy akte noteriale me elemente të ndryshme nga njëri-tjetri për të njëjtin objekt shitjeje, përshkruar në pasurinë nr. 5 të vendimit të Komisionit; iv) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë e përshkruar në pikën 10 të vendimit të Komisionit; v) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë nr. 11 të vendimit të Komisionit, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, ka kryer deklaram të pasaktë për këtë pasuri; vi) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë e përshkruar në pikën 12 të vendimit të Komisionit; vii) ka pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera ndër vite (për vitet 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015), me burimet financiare të deklaruara dhe dokumentuara, në total në vlerën -3.880.003 lekë.

³ Raporti i KLP-së me nr. {***} prot., datë 15.05.2019.

8.2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, mbi dyshimet e ngritura në raportin e DSIK-së, në të dyja çështjet penale, trupi gjykues i Komisionit i ka çmuar ato në vlerësimin tërësor të cenimit të besueshmërisë ndaj publikut.

8.3 Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, trupi gjykues i Komisionit krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara nuk mund të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, por i çmoi këto mangësi si sjellje të subjektit në favor të të pandehurve në mospërbushje të rolit të prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

- 9.** Më datë 01.08.2019, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit ankimin ndaj vendimit nr. 160, datë 14.06.2019, me të cilin është njoftuar më datë 22.07.2019. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 63⁴, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në çdo faqe të ankimit. Më datë 20.11.2020, fillimisht në rrugë elektronike, dhe më pas më datë 23.11.2020 me postë të thjeshtë, subjekti i rivlerësimit solli në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) edhe parashtrimet e tij konform nenit 49, paragrafi 2, fjalia e fundit e ligjit nr. 49/2012. Në konkluzion të ankimit të tij, si edhe në parashtrime, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t’i marrë në shqyrtim Kolegji dhe, në përfundim, kërkoi:

9.1 Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, marrjen e provave të reja dhe, pas gjykimit në fakt, ndryshimin e vendimit nr. 160 datë 14.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena.

Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

9.2 Lidhur me kërkimet me natyrë procedurale, subjekti i rivlerësimit pretendon nëpërmjet ankimit kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes në Kolegji, si dhe marrjen e provave të reja të cilat i ka bashkëlidhur në ankim.

9.3 Lidhur me pasurinë⁵ “apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m² ndodhur Kukës, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk duhet të kishte arritur në konkluzionin e deklaramentit të pasaktë për sa i përket shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie sepse, sipas tij, ka qenë një lapsus deklarimi në vlerën 500.000 lekë të kësaj pasurie në vitin 2003, i cili nuk mund ta penalizojë meqenëse subjekti i rivlerësimit e ka korrigjuar këtë gabim në vitet në vazhdim dhe në deklaratën *vetting* duke e deklaruar vlerën e saktë 600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e konsideron këtë si një gabim njerëzor duke qenë se nga ai vetë janë paraqitur dokumentet në ILDKPKI. Sipas tij, është e deklaruar saktë kjo pasuri në deklaratën *vetting*.

⁴ Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelineve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

⁵ Pasuri e trajtuar në paragrafin nr. 1 e në vijim të faqes nr. 5 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

9.3.1 Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se në analizën financiare të paraqitur nga Komisioni në vendim, konstatohet se nuk janë përfshirë në llogaritje të ardhurat nga paga e nënës së subjektit të rivlerësimit nga viti 1991-1993, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën e Komisionit të ardhurat e babait të tij janë përlllogaritur në shumën 90.502 lekë, duke përlllogaritur këtu vetëm të ardhurat nga pensioni i invaliditetit dhe nuk janë llogaritur të ardhurat nga pagat si punonjës në Shërbimin Sinoptikan, në Kukës. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni në analizën e tij nuk ka llogaritur kursimet e mundshme të subjektit të rivlerësimit si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Kukës nga data 01.04.1998 - 20.12.1999, kur është blerë edhe shtëpia.

9.3.2 Subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se, përpos fakteve që provojnë burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie nga ana e prindërve të tij, Komisioni nuk ka zbatuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në gjykim, parim i cili sipas tij duhet të drejtojë këtë proces, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokuror kur është krijuar kjo pasuri. Subjekti i rivlerësimit pretendon se periudha para ushtrimit të detyrës duhet vlerësuar me objektivitet dhe proporcionalitet, duke e lidhur me veprimet apo mosveprimet që mund të kenë sjellë pasojën.

9.4 Lidhur me aktmarrëveshjen⁶ për premtim shitje, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo marrëveshje nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik dhe është revokuar në heshtje nga të dyja palët dhe më pas është revokuar me shkrim nga ana e z. D. B kur është revokuar kontrata e porosisë me nr. {***}, për blerjen e këtij apartamenti me një kontratë tjetër porosie me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 21.04.2007, vetëm pak muaj më pas. Revokimin e saj e ka pranuar edhe shtetasi D. B me deklaratë noteriale edhe kur është pyetur nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka paraqitur të gjitha mandatarkëtimet për këstet e paguara nga ky shtetas për blerjen e apartamentit në fjalë.

9.4.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimi i Komisionit se ai ka paguar vlerën 28.000 euro, është i gabuar. Ai pretendon se mendonte të merrte kredi bankare për shlyerjen e kësaj shume, duke qenë se nuk ka pasur të ardhura të tjera, përveç atyre të pagës së tij dhe të pagës së bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, citimi në aktmarrëveshje nga ana e noterit, se janë likuiduar 28.000 euro, është një gabim dhe përgjegjësi e noterit. Ai ngre pretendimin se noteri ka deklaruar qartë se shkrimi në aktmarrëveshje, se është dhënë shuma prej 28.000 eurosh, ka qenë një gabim i tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që ka aplikuar për një kredi, tregon se nuk e ka paguar këtë shumë. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

9.4.2 Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij pretendon se, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, nuk ka pasur detyrimin ligjor për ta deklaruar këtë veprim, duke qenë se nuk është paguar asnjë vlerë nga ana e tij. Në

⁶ Aktmarrëveshje për premtim shitjeje nr. {***}, datë 11.07.2006, trajtuar në paragrafin 3 e në vijim të faqes 10 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.04.2007, lidhur mes shtetasit D. B dhe shoqërisë “{***}” për pronësinë e apartamentit 2+1 është shkruar dhe është shprehur qartë se revokohet kontrata e porosisë me nr. {***} rep., datë 17.03.2006, çka ka bërë të revokueshme edhe aktmarrëveshjen e datës 11.07.2006, si pjesë e saj.

9.5 Lidhur me mjetin “autoveturë Volkswagen”⁷, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se përfundimi i Komisionit se ai ka njohur dhe ka pranuar dy akte noteriale me elemente të ndryshme nga njëri-tjetri për të njëjtin objekt shitjeje, duke cenuar etikën e prokurorit, është i pabazuar në fakte, në prova dhe në ligj. Sipas subjektit të rivlerësimit, automjeti është blerë me kredi sipas dokumenteve të administruara në dosje.

9.5.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se Komisioni arrin në përfundimin e gabuar se kontrata e shitblerjes së automjetit e datës 03.10.2009, e noterizuar në prani të palëve kontraktore, me vlerën 1.000.000 lekë, është bërë në një moment kur automjeti nuk kishte hyrë ende në territorin e Shqipërisë, me arsyetimin se sipas deklaratës doganore, ka hyrë në Shqipëri në datën 09.10.2009, në një kohë që automjeti ka qenë në Shqipëri që në datën 15.04.2009, sipas vërtetimit doganor. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ngatërron dokumentet duke e quajtur si të hyrë datën e zhdoganimit të mjetit, por, sipas tij, në atë kohë mjetet mund të zhdoganoheshin në çdo zyrë doganore të vendit tonë.

9.6 Lidhur me të ardhurat e shtetasit D. B.⁸, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, e ka konsideruar këtë shtetas si person që përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur me të, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit ka pohuar në vitet 2011 dhe 2012 që e ka përdorur këtë pasuri me qira, pa kundërshtim, çka nënkupton se ka hyrë në një marrëdhënie interesi pasuror dhe, si rrjedhojë, ka kërkuar dokumente dhe shpjegime lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit. Ai shpjegon se nuk ka qenë në marrëdhënie të interesit pasuror me shtetasin B. për një vit e gjysmë që nuk kanë formalizuar kontratën e qirasë, sepse ai nuk ishte bërë ende pronar i apartamentit, por ishte porositës i tij.

9.7 Lidhur me mjetin “autoveturë Opel Corsa C14”⁹, subjekti i rivlerësimit pretendon se autovetura është blerë në datën 23.02.2014 dhe Komisioni ka kryer një analizë financiare për periudhën pasi është blerë kjo autoveturë. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga fundi i muajit qershor 2013 deri një vit më pas, bashkëshortja e tij është paguar nga sigurimet shoqërore sepse ka qenë me leje lindjeje dhe këto të ardhura, sipas tij, nuk janë përlllogaritur nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare janë përlllogaritur nga ana e Komisionit shpenzimet e jetesës për 4 persona, por në fakt pretendon se personi i katërt, vajza e tij, ka lindur në datën 10.07.2018 dhe është trajtuar me shpenzime njësoj si një i rritur, edhe pse ushqehet vetëm me gjirin e nënës.

⁷ Pasuri e trajtuar në paragrafin nr. 5 e në vijim të faqes nr. 15 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

⁸ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 10 e në vijim të faqes nr. 20 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

⁹ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 11 e në vijim të faqes nr. 22 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

9.7.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se konkluzioni i Komisionit se ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për zhdoganim, është i pabazuar në analizën e dokumenteve të paraqitura dhe nuk mund të jetë penalizues për të. Sipas tij, deklarimi i zhdoganimit të mjetit është bërë mbi bazën e dokumenteve të mjetit. Subjekti pretendon se dogana ka vendosur në dy fletët e zhdoganimit me nr. {***}, vlera statistikore të ndryshme, duke iu referuar çmimit të referencës. Të dyja këto fletë janë paraqitur së bashku me deklaratën *vetting* dhe nuk mund të penalizohet subjekti për një gabim të punonjësit të doganës në përpilimin e dokumenteve.

9.8 *Në lidhje me pasurinë¹⁰ “tokë bujqësore”, ndodhur në Kolonjë, Lushnjë, pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me prindërit e saj*, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, pas hetimit, ka arritur në përfundimin se Komisionit nuk i rezultuan dyshime mbi ekzistencën e kësaj pasurie dhe se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje dhe, për këtë arsye, përfundimi i Komisionit i arritur në vlerësimin tërësor të çështjes, për sa i përket pasurisë dhe në lidhje me këtë pasuri, duhet të rrëzohet nga Kolegji si i pabazuar në prova dhe në ligj.

9.9 *Lidhur me analizën financiare¹¹ të viteve 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015*, subjekti pretendon se përfundimi i Komisionit që subjekti ka pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera ndër vite (për vitet 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015) me burime financiare të deklaruara dhe dokumentuara, në total në vlerën 3880.003 lekë, është i gabuar, i pasaktë, i pabazuar në fakte dhe dokumente, por i kryer mbi baza statistikore dhe jo dokumentare.

9.10 *Lidhur me procedimin penal¹² nr. {***} të vitit 2012*, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai nuk depozitoi prova për të provuar se transferimi ishte kryer me kërkesë të pandehurve, është i pabazuar në ligj. Asnjëherë gjatë hetimit, Komisioni nuk i ka kërkuar të paraqesë prova se përse çështja gjykohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ashtu sikurse ka vepruar në çdo rast, edhe në çështje të tjera të ngjashme gjatë hetimit administrativ, Komisioni duhet të kërkonte vetë çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të studionte dosjen dhe të arrinte pastaj në konkluzionet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky moment procedural konsumohet në fillim të çeljes së shqyrtimit gjyqësor.

9.11 *Lidhur me procedimin penal¹³ nr. {***} të vitit 2015*, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimet e nxjerra nga Komisioni, janë të pabazuara në ligj. Sipas tij, në asnjë rast në Kodin e Procedurës Penale, apo në ligjet e tjera ku është mbështetur vendimi i Komisionit, nuk parashikohet se në vendim duhen të pasqyrohen urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto gjetje të Komisionit janë të pabazuara dhe duhen të rrëzohen.

¹⁰ Pasuri e trajtuar në paragrafin nr. 12 e në vijim të faqes nr. 25 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹¹ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 14 e në vijim të faqes nr. 26 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹² Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 1 e në vijim të faqes nr. 30 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹³ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 2 e në vijim të faqes nr. 30 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

9.12 Lidhur me procedimin penal¹⁴ nr. {*} të vitit 2015**, subjekti i rivlerësimit pretendon se në pjesën konstatuese të vendimit është evidentuar fakti se për ndërtimin e shtesës prej 22 m² të lokalit, nuk mund të bëhet ndjekje penale për "Ndërtim të paligjshëm", bazuar në nenin 4 të K.Pr.Penale dhe ligjeve nr. 22/2014 dhe nr. 92/2015, dhe jo për faktin e konstatuar më datë 24.07.2015, për të cilin ishte referuar materiali kallëzues, vendosja e vetratave prej duralumini dhe riparimi i fasadës së lokalit. Pikërisht për këtë fakt është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi vendosja e dyerve dhe dritareve, punimet për riparim fasade objekti, vendosje reklamash etj., janë përjashtuar nga leja e ndërtimit, sipas VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, është parashikuar se: "Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet". Sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin në fjalë, Komisioni ka luajtur rolin e prokurorit, duke zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e tij në arsyetimin e vendimit.

9.13 Lidhur me masën disiplinore¹⁵ "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pretendoi në ankim se, për sa i përket marrjes në shqyrtim të masës disiplinore të dhënë ndaj tij në kohën kur ka qenë në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për shkak të moskryerjes së disa veprimeve hetimore në një procedim penal të vitit 2003, pavarësisht se ka dhënë shpjegime, rezulton se Komisioni ka tejkualuar kompetencat e tij ligjore, duke marrë në shqyrtim këtë çështje, në kundërshtim me nenin 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: "Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale [...]". Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo çështje që lidhet me këtë masë disiplinore, nuk duhet të merret parasysh në vlerësim tërësor të çështjes.

9.14 Lidhur me praktikën¹⁶ nr. {*} të vitit 2014**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka konstatuar se ndaj vendimit të pushimit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, është ushtruar ankim në gjykatë dhe çështja është në shqyrtim. Sipas tij, neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, mes të tjerash, parashikon se: "Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që nuk janë në shqyrtim dhe, në këto kushte, është në kapërcim të kompetencave të tij, prandaj nuk duhet të merret parasysh në vlerësimin tërësor të çështjes".

9.15 Lidhur me procedimin penal¹⁷ nr. {*} të vitit 2006**, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se nuk ka depozituar aktin për zëvendësimin e tij në fazën e diskutimeve përfundimtare është i gabuar, sepse nga aktet rezulton se çështja është hetuar dhe dërguar për gjykim nga vetë Drejtuesi i Prokurorisë. Ai nuk ka zëvendësuar një prokuror të thjeshtë që mund të kishte hetuar çështjen me një prokuror tjetër. As vetë, nuk ka qenë në kushtet e zëvendësimit sipas

¹⁴ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 3 e në vijim të faqes nr. 30 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹⁵ Çështje e trajtuar në paragrafin nr. 4 e në vijim të faqes nr. 32 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹⁶ Çështje e trajtuar në fund të faqes nr. 33 e në vijim të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

¹⁷ Çështje e trajtuar me titull "Dosja penale nr. 1", në vijim të faqes nr. 35 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

neneve 26 dhe 27 të K.Pr.Penale, përndryshe duhet të vendoste Prokurori i Përgjithshëm lidhur me zëvendësimin e tij.

9.15.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se nuk mund të penalizohet për zbatim të ligjit, por për moszbatim të tij. Kërkimi i dënimit me gjobë për të pandehurin në çështjen e vitit 2006, megjithëse është i ligjshëm, nuk është bërë privatisht, por pas konsultës paraprake me drejtuesin e prokurorisë, në zbatim të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilin vetë trupi gjykues e citon në vendim. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit se ai ka vepruar në kundërshtim me nenin 484 të K.Pr.Penale, është i gabuar dhe duhet të rrëzohet nga Kolegji sepse, siç theksohet edhe në vendimin e Komisionit, çështja nuk është hetuar dhe dërguar për gjykim nga ana e subjektit të rivlerësimit, por nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, i cili duhet të kërkonte dhe të administronte vërtetimin e gjendjes gjyqësore për të pandehurin gjatë hetimit të procedimit.

9.16 Lidhur me procedimin penal¹⁸ nr. {*} të vitit 2010**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vlerësimi i Komisionit që ai, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv, në përputhje me pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, është tërësisht i pabazuar në ligj, i paragjykuar, pa asnjë bazë, vetëm me hamendësime. Subjekti i rivlerësimit thekson se nga provat e grumbulluara për atë procedim, nuk mund të dilej në përfundimin se ishte kryer vepra penale. Vendimi është marrë pas një hetimi të plotë të çështjes, nga ku nuk është provuar se malli i sekuestruar i personit nën hetim, të ishte me origjinë kontrabande, ashtu sikurse është arsyetuar në vendim.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe

¹⁸ Çështje e trajtuar me titull "Dosja penale nr. 2", në vijim të faqes nr. 37 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

ratione temporis pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65¹⁹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 160, datë 14.06.2019, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

12.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja²⁰ të akteve të cilat subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur ankimit të dorëzuar më datë 01.08.2020, si dhe kërkesën e tij të parashtruar në ankim, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

12.2 Pasi e shqyrtoi këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit* – Kolegji, me vendim të ndërmjetëm, çmoi të vendosë refuzimin e marrjes në cilësinë e provave të reja të akteve të paraqitura me ankim nga subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar si vijon.

12.3 Në verifikim të parashikimeve ligjore, në rastin konkret vlerësohet se provat e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, përveç se nuk mbështeteshin mbi fakte që provonin mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision,

¹⁹ “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

²⁰ 1. Vërtetim hyrje automjeti, datë 15.04.2009, me nr. serie {***}. 2. Revokim kontrate premtim shitje, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 24.06.2019. 3. Deklaratë noteriale nr. {***} prot., datë 06.02.2019. 4. Certifikatë e mbajtësit (në anglisht), fotokopje, për mjetin “Passat”, datë 26.02.2009. 5. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 06.02.2019. 6. Vërtetim i Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë, nr. {***} prot., datë 20.10.2016. 7. Kontratë qiraje nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 10.02.2018. 8. Kontratë qiraje nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 29.01.2019. 9. Vendimet për vlerësimin e punës për vitet 2012, 2013 dhe 2015 (3 vendime). 10. Vërtetim nr. {***} prot., dt 23.07.2019, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Kukës. 11. Vërtetim negativ nr. {***} prot., datë 24.07.2019, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Kukës. 12. Vërtetim nr. {***} prot., dt 24.07.2019, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Kukës. 13. Vërtetim negativ nr. {***} prot., dt 24.07.2019, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Kukës. 14. Formular aplikimi për vite pensioni nga B. C., datë 23.07.2019. 15. Certifikata lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës (15 certifikata). 16. Shkresë nr. {***} prot., datë 18.07.2019, e Komisionit, për njoftimin e vendimit. 17. Zarfi i njoftimit të vendimit, me shënimet postare.

siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por edhe sikur të ishin në plotësim të këtyre kriterëve, u konsideruan si të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për më tepër dhe si të tilla që, edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë nëpërmjet tyre, përsëri nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

12.4 Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegj, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë publike nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu Kolegji kryesisht vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

12.5 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vlerësoi gjithashtu edhe nevojën e marrjes së këtyre provave në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me zbatimin e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 pasi e gjeti të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, siç u përshkrua më sipër dhe, duke qenë se as vetë kryesisht Kolegji nuk konstatoi ekzistencën e ndonjë prej kushteve të parashikuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon rastet se kur një gjykim administrativ në Gjykatën e Apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike, vendosi ta shqyrtojë çështjen në formën e gjyqimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

13. Lidhur me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m², ndodhur Kukës, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se Komisioni nuk duhet të kishte arritur në konkluzionin e deklaramit të pasaktë për sa i përket shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie sepse, sipas tij, ka qenë një lapsus deklarimi në vlerën 500.000 lekë i kësaj pasurie në vitin 2003, i cili nuk mund ta penalizojë, meqenëse ai e ka korrigjuar këtë gabim në vitet në vazhdim dhe në deklaratën *vetting*, duke e deklaruar vlerën e saktë 600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e konsideron këtë si një gabim njerëzor, duke qenë se nga ai vetë janë paraqitur dokumentet në ILDKPKI. Sipas tij, është e deklaruar saktë kjo pasuri në deklaratën *vetting*. Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

13.1 Me kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 20.12.1999, provë e administruar në Komision nga praktika e ZVRPP²¹-së Kukës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e kishte blerë këtë pasuri nga shtetasit R. D, F. D, Xh. D, N. D. dhe B. D., përfaqësuar me prokurë nga shtetasi M. K.. Çmimi i referuar në këtë kontratë për blerjen e kësaj pasurie,

²¹ Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

rezulton në vlerën 600.000 lekë. Kjo pasuri rezulton e regjistruar më datë 07.12.2000, pranë ZVRPP Kukës.

13.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit këtë pasuri e ka deklaruar “apartament banimi 1+1, me vlerë 500.000 lekë, me vendndodhje në Kukës, me burim krijimi me pagë”.

13.3 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me sip. 55,25 m², L. nr. {***}, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Kukës, me nr. pasurie {***}, vol {***}, faqe {***}, Zona Kadastrale {***}, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 20.12.1999, blerë nga kursimet e prindërve B. e F. C., me vlerë 600.000 lekë të reja, me pjesë takuese 50%.

13.4 Kolegji vëren se në dy deklaratimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e pasurisë në shuma të ndryshme, në vitin 2003 e ka deklaruar 500.000 lekë, ndërsa në deklaratën *vetting* e ka deklaruar vlerën për blerjen e kësaj pasurie, 600.000 lekë. Në kontratën e shitblerjes së apartamentit, është përcaktuar vlera prej 600.000 lekësh e blerjes së saj. Komisioni, nisur nga vlerat e pasurisë të deklaruara ndryshe në deklaratimet e mësipërme, ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me këtë mospërputhje, i cili në përgjigje të pyetësorit, datë 05.02.2019, ka shpjeguar se: *Është e vërtetë se në deklaratën e vitit 2003, është deklaruar nga ana ime se ky apartament është blerë me të ardhurat nga rroga, por ky deklaram i imi, ka qenë rezultat i një lapsusi apo, më saktë të themi, i paplotë. Kjo pasi ishte hera e parë që bëhej deklaram pasurie jo vetëm për mua, por për të gjitha subjektet e rivlerësimit. Ky deklaram, siç edhe ju e keni parë, është bërë me shkrim dore, dhe në këtë moment pa asnjë qëllim kam harruar që pas fjalës “rrogë”, të shtoja fjalën e “prindërve”. Këtë fakt e kam pasqyruar edhe në deklaratën “vetting”, ku është sqaruar se ky apartament është blerë me paratë e fituara nga paga ndër vite e prindërve të mi, të cilët më kanë ndihmuar në blerjen e apartamentit, në vlerën 600.000 mijë lekë, në qytetin e Kukësit, ku unë punoja, pasi ata jetonin në fshatin Bicaj. Unë kam filluar punë për herë të parë më datë 01.04.1998, si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Kukësit, dhe për rrjedhojë nuk mund ta blija me rrogën time apartamentin, një vit më pas.*

13.5 Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në dosjen e ardhur nga Komisioni, rezulton se vlera e apartamentit e deklaruar në deklaratën *vetting*, përputhet me vlerën e blerjes së kësaj pasurie në kontratën e shitblerjes së pasurisë së vitit 1999, duke bërë të saktë këtë deklaramin në deklaratën *vetting*. Pasaktësia, referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe problematikat që janë konstatuar në këtë rast, nuk mund të renditen në grupin e pasaktësive që Komisioni ka renditur si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

- 14.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se në analizën financiare të paraqitur nga Komisioni në vendim, konstatohet se nuk janë përfshirë në llogaritje të ardhurat nga paga e nënës së subjektit për periudhën mes viteve 1991-1993, edhe pse ai ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën e Komisionit, të ardhurat e babait të tij janë përlllogaritur në shumën 90.502 lekë, duke përlllogaritur këtu vetëm të ardhurat nga pensioni i invaliditetit dhe nuk janë llogaritur të ardhurat nga pagat si punonjës në Shërbimin Sinoptikan në Kukës. Ai pretendoi se Komisioni në analizën e tij nuk ka llogaritur kursimet e mundshme si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Kukës, nga data 01.04.1998 - 20.12.1999, kur është blerë edhe shtëpia.

Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

14.1. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ardhur nga Komisioni, vërtetohet se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë qenë në marrëdhënie pune prej vitit 1961, por në vërtetimet e administruara nuk pasqyrohen të ardhurat e përfituara nga këto punësime. Bazuar në qëndrimet²² e mbajtura nga Kolegji më parë për mundësinë e krijimit të kursimeve nga të ardhurat përpara vitit 1991, të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit nuk mund të jenë në nivel të konsiderueshëm për të krijuar kursime për blerje pasurie të paluajtshme, duke qenë se këto të ardhura të përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, mund të konsiderohen relativisht të papërfillshme për shkak të krizës drastike financiare, ndryshimeve politike dhe për pasojë edhe të inflacionit në një shkallë deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare gjatë atyre viteve.

14.2 Bazuar në pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përlogaritur të ardhurat e prindërve për vitet 1991-1999, sipas vërtetimeve të administruara në dosje nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me nr. {***} prot., datë 26.02.2019, shkresës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Kukës, me nr. {***} prot., datë 08.02.2019 dhe shkresës së të njëjtit institucion me nr. {***} prot., datë 19.02.2019, shkresës së Drejtorisë Rajonale Kukës me nr. {***} prot., datë 20.02.2019, dhe vërtetimit nr. {***} prot., datë 19.02.2019, rezulton se të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit për periudhën e punësimit nga viti 1991-1999, janë përlogaritur në vlerën 715483 lekë. Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 18.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga puna e tij si oficer i policisë gjyqësore nga data 01.04.1998 - 31.12.1999, vlerën 630.150 lekë. Duke konsideruar shpenzimet²³, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë, rezultoi se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve të tij deri në vitin 1999, nuk ishin të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, për vlerën -574485 lekë dhe gjithashtu për të krijuar pasurinë apartament banimi në qytetin e Kukësit. Për të njëjtat të dhëna, në Kolegj u kryen përlogaritjet edhe duke konsideruar shpenzime jetese minimale përkatësisht në nivelin 30% të të ardhurave deri në vitin 1998 dhe për vitin 1999 shpenzimet e jetesës janë përlogaritur sipas anketës së buxhetit të familjes 2000 të kryer nga INSTAT. Edhe duke konsideruar këtë nivel të shpenzimeve të jetesës, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe krijuar pasurinë për vlerën negative 90057 lekë. Në konkluzion të sa më sipër sa i përket shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit ngritur në ankim, Kolegji e gjen të pabazuar atë dhe jobindës shpjegimin e subjektit të rivlerësimit për burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m².

15. Subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin në ankim se, përpos fakteve që provojnë burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie nga ana e prindërve të tij, Komisioni nuk ka zbatuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në gjykim, parim i cili sipas tij duhet të drejtojë këtë proces, duke qenë se ai nuk ka qenë prokuror kur është krijuar kjo pasuri. Subjekti i rivlerësimit kërkon që periudha para ushtrimit të detyrës të vlerësohet me objektivitet dhe proporcionalitet, duke e

²² Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 14/2019, datë 09.07.2019, paragrafi nr. 23.14.

²³ Raporti i Bankës së Shqipërisë të vitit 1995 specifikon se: “[...] të ardhurat vjetore për frymë të popullsisë në fund të vitit 1995 kanë arritur nivelin në afërsisht 800 USD nga 330 USD që ishin në vitin 1993. Sipas disa përlogaritjeve të përafërta, supozohet se përqindja e kursimeve të popullatës në fund të vitit 1995 mund të jetë rreth 34% nga 29% që ishte në fund të vitit 1992”.

https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/Raporti_Vjetor_1995.html - Burimi INSTAT, anketa ABF2000.

lidhur me veprimet apo mosveprimet që mund të kenë sjellë pasojën. Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegji arsyeton si më poshtë.

15.1 Në konsideratë të pranimit të mungesës së burimeve të ligjshme, me ngritjen në formën e një shkakut ankimi nga subjekti i rivlerësimit të zbatimit të parimit të proporcionalitetit, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, Kolegji i referohet ligjit të posaçëm dhe konkretisht nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”. Sipas dispozitave referuese, në vlerësimin e Kolegjit, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes dhe synojnë që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit.

15.2 Nga analizimi dhe interpretimi i dispozitave të cituara me sipër, lidhur me parimin e proporcionalitetit në funksion të shkakut të ankimit, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të zbatuar parimin e proporcionalitetit lidhur me këtë pasuri, nuk është i bazuar, pasi zbatimi i tij kërkon që në vlerësimin tërësor të çështjes, të konkludohet për peshën dhe rëndësinë që ka çdo shkelje në lidhje me masën disiplinore “shkarkim nga detyra”. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbatimin e parimit të proporcionalitetit në këtë rast, nuk afekton vlerësimin vetëm për kriterin e pasurisë. Sa më sipër, shkakut i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është i bazuar në ligj.

15.3 Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m², ndodhur Kukës, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, Kolegji, sikurse Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e kësaj pasurie, pasi rezultoi e provuar se ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara, për pasojë, në përputhje me nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, përmbushet në vlerësimin e Kolegjit definicioni i mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë në kuptim dhe zbatim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 16.** *Lidhur me “Aktmarrëveshjen për premtim shitje”* me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 11.07.2006, të lidhur me shtetasin D. B., me qëllim blerjen e një apartamenti 1+1 në Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo marrëveshje nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik dhe është revokuar në heshtje nga të dyja palët dhe më pas është revokuar me shkrim nga ana e z. D. B kur është revokuar kontrata e porosisë me nr. {***} për blerjen e këtij apartamenti me një kontratë tjetër porosie me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 21.04.2007, vetëm pak muaj më pas. Revokimin e saj e ka pranuar edhe shtetasi D. B., me deklaratën noteriale, si dhe kur është pyetur nga Komisioni.

Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

16.1. Me kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.08.2006, subjekti i rivlerësimit kishte përfituar nga Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) shumën prej 1.000.000 lekësh, me qëllim “blerje apartamenti” për një afat shlyerjeje 120 muaj nga data e disbursimit, dhe se për të garantuar këtë kredi, ishte vendosur në hipotekë pasuria e paluajtshme apartament, me sipërfaqe 55,25 m² (përshkruar në paragrafin 13.1). Sipas llogarisë së subjektit të rivlerësimit, në BKT rezultoi se kredia ishte disbursuar në datën 23.08.2006, në shumën 980.000 lekë, dhe po në të

njëjtën datë ai kishte tërhequr shumën e disbursuar *cash*. Në praktikën e kësaj kredie, konstatohet e administruar një aktmarrëveshje siguroese me titull “Aktmarrëveshje për premtim shitjeje” nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 11.07.2006, sipas së cilës shtetasi D. B i shiste subjektit të rivlerësimit të drejtat reale mbi një apartamenti 1+1, të përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.03.2006, për çmimin 40.500 euro. Në përmbajtjen e aktmarrëveshjes për premtim shitjeje, të cilën nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit ta ketë deklaruar në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *vetting*, konstatohet të jetë cituar nga noteri B. Gj., ndër të tjera, se: “Me nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshjeje, është likuiduar vlera prej 28.000 eurosh në dorë, nga pala blerëse (Shkëlzen Cena)”.

16.2 Sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.03.2006, rezulton se shtetasi D. B kishte porositur pranë shoqërisë “{***}” ShPK, ndërtimin e një apartamenti banimi 1+1, dhe se bazuar në nenin 4 të saj, pagesa parashikohej të shlyhej në tri këste, përkatësisht 28.000 euro në datën e nënshkrimit të kontratës, 8.000 euro brenda muajit janar të vitit 2007 dhe 4.500 euro me dorëzimin e objektit brenda muajit qershor. Rezultoi se, sipas aktmarrëveshjes për premtim shitjeje të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. B., subjekti i rivlerësimit në datën e nënshkrimit të saj, më 11.07.2006, i kishte paguar *cash* në dorë këtij shtetasi shumën 28.000 euro. Po sipas kësaj aktmarrëveshjeje dhe kushteve të përcaktuara në të, rezulton se subjekti i rivlerësimit do të shlyente pagesën e kështit të dytë dhe të tretë, përkatësisht në janar 2007 dhe qershor 2007, pra parashikohej që likuidimi i apartamentit të bëhej brenda vitit 2007. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2006 detyrimin që ai kishte pasur sipas aktmarrëveshjes për të paguar në vitin 2007 dy këstet e tjera të pasurisë.

16.3 Duke qenë në një situatë të tillë të paqartësuar, Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë fakt, i cili në përgjigje të pyetësorit të datës 05.02.2019, ka shpjeguar se: *Realizimi i kësaj aktmarrëveshjeje me nr. {***}, datë 11.07.2006, u bë i pamundur, pasi unë mora kredi në BKT vetëm 1.000.000 lekë, më datë 23.08.2006, një muaj më pas, dhe faktikisht kjo marrëveshje u zgjidh në heshitje, pasi nuk kishim asnjë kontradiktë me D.. Banka BKT nuk më dha kredi në atë masë, sipas bisedimeve që bëmë, pasi unë kisha edhe dy kredi të tjera personale në Raiffeisen Bank, të marra në datat 31.05.2005 dhe 02.03.2006. Nga dokumentacioni i administruar në dosje gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, nuk rezultoi të jetë nënshkruar ndonjë akt tjetër noterial, i cili të revokojë kontratën/aktmarrëveshjen për premtim shitjeje, e cila tashmë kishte filluar të jepte efektet që nga pagesa e parë e kështit, me qëllim likuidimin e apartamentit nga ana e subjektit të rivlerësimit.*

16.4 Komisioni, lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 28.000 eurosh, si dhe për kryerjen e pagesave të tjera sipas kontratës me shtetasin D. B., e ka pyetur subjektin e rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit të datës 05.02.2019, ka shpjeguar se: *Kur kam takuar shokun tim D. në Kukës, në bisedë e sipër ai më tha se kishte prenotuar një apartament 1+1, në Tiranë, tek një objekt që po ndërtohej nga shoqëria “{***}” në rr. “{***}” në Tiranë, shoqëri me të cilën kishte lidhur edhe kontratën e sipërmarrjes me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 17.03.2006. Në një moment, i thashë se kam dëshirë të blej edhe unë një apartament të vogël në Tiranë, po mora kredi*

*në bankë, sepse doja të largohesha nga Kukësi. Dhe kështu, më datë 11.07.2006, bëmë edhe marrëveshjen e mësipërme. Nëse unë do merrja kredinë menjëherë, ai do të bisedonte me shoqërinë e ndërtimit “{***}” që të m’i kalonte mua të drejtat që buronin nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 17.03.2006, me të cilën ai kishte porositur një apartament 1+1, dhe unë do t’i paguaja edhe shumën prej 28.000 eurosh, që ai ia kishte paguar si këst shoqërisë ditën e hartimit të kontratës së sipërmarrjes. Pra, ditën e hartimit të aktmarrëveshjes, datë 11.07.2006, nuk i është bërë asnjë pagesë në dorë apo me bankë D., pasi realisht nuk kisha të ardhura përveç pagës sime dhe të bashkëshortes, por mendoja të merrja shpejt kredi bankare, dhe t’ia jepja [...]. Ndërkohë shtetasi D. B., pak muaj më pas ka revokuar edhe kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.03.2006, për porositjen e apartamentit 1+1, sepse kishte porositur një apartament tjetër me sipërfaqe më të madhe, në një seksion tjetër të asaj godine me kompozicion 2+1, me kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.04.2007, apartament të cilin e ka në pronësi dhe sot, dhe ku unë banoj me qira.*

16.5 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision një tjetër kontratë sipërmarrjeje me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 21.04.2007, të lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe shtetasit D. B., nga ku rezulton se ky i fundit ka porositur një tjetër apartament 2+1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nëpërmjet kësaj kontrate është revokuar kontrata e lidhur mes tij dhe D. B., me titull “Aktmarrëveshje për premtim shitjeje”. Kjo kontratë e dytë e sipërmarrjes mes shoqërisë “{***}” dhe z. B. është lidhur për të rregulluar një marrëdhënie juridike tjetër mes shtetasit D. B kundrejt shoqërisë “{***}” ShPK, ndaj një kontratë e tillë me pasoja juridike vetëm për dy palë (B. - “{***}”), nuk mund të përfshijë subjektin e rivlerësimit që nuk rezulton të jetë palë nënshkruese e saj. Për më tepër, Kolegji, nisur nga parashikimi i kontratës me titull “Aktmarrëveshje për premtim shitjeje”, nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 11.07.2006, lidhur mes shtetasit D. B. dhe subjektit të rivlerësimit, konstaton se pretendimi në ankim se kemi të bëjmë me revokim në heshtje të një kontrate “tip” dhe me gabime të noterit, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, është jobindës pasi është përcaktuar qartë shuma, fakti që është paguar, si dhe është specifikuar me emër dhe mbiemër subjekti i rivlerësimit si pagues i kësaj shume kundrejt marrësit D. B..

16.6 Sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.02.2019, të shtetasit D. B., të depozituar në Komision nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, deklarohen të njëjtat qëndrime të subjektit të rivlerësimit të mbajtura në përgjigjet e rezultateve të hetimit. Lidhur me këtë deklaratë noteriale, Kolegji ka në vëmendje qëndrimet²⁴ që ka mbajtur në çështje të ngjashme, sipas të cilave, megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka

²⁴ Vendimi nr. 6/2018(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36.
Vendimi nr. 11/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1.
Vendimi nr. 34/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. *Kolegji vlerëson se shkaku i ankimit nuk gjendet i bazuar në prova e në ligj.*

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimi i Komisionit se ai ka paguar vlerën 28.000 euro, është i gabuar. Ai pretendon se mendonte të merrte kredi bankare për shlyerjen e kësaj shume, duke qenë se nuk ka pasur të ardhura të tjera përveç atyre të pagës së tij dhe të pagës së bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, citimi në aktmarrëveshje nga ana e noterit, se janë likuiduar 28.000 euro, është një gabim dhe përgjegjësi e noterit. Ai ngre pretendimin se noteri ka deklaruar qartë se shkrimi në aktmarrëveshje se është dhënë shuma prej 28.000 eurosh, ka qenë një gabim i tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që ka aplikuar për një kredi, tregon se nuk e ka paguar këtë shumë. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

17.1 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi të ketë veprime bankare apo mandatarkëtime të pagesave të kësteve për kontratën me titull “Aktmarrëveshje për premtim shitjeje”, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe z. B.. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për kredi në bankën BKT, në objekt të kontratës të së cilës është cilësuar “për blerje shtëpie”, kredi e cila është disbursuar në vlerën 980.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit pranon faktin në shpjegimet që ka dhënë në pyetësin datë 05.02.2019 të Komisionit, se nuk kishte të ardhura për të blerë apartamentin, por do të merrte kredi për ta blerë, nga ana tjetër thotë që kredia nuk u disbursua në vlerën që kishte kërkuar dhe kontrata me titull “Aktmarrëveshje për premtim shitjeje” u revokua në heshtje, por gjithsesi ai e mori kredinë në shumën (980.000 lekë), pasi nga llogaria bankare e ekstraktuar nga BKT-ja, rezultoi se këtë shumë e ka tërhequr *cash* pas disbursimit. Nuk rezultoi e provuar se sa ka qenë shuma e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit te banka. Si rrjedhë e një logjike të thjeshtë, nëse nuk i është disbursuar kredi nga banka aq sa ka dëshiruar/kërkuar subjekti i rivlerësimit, ky i fundit mund mos ta merrte kredinë si të panevojshme, por e ka pranuar dhe ka firmosur kontratën e kredisë, duke u bërë kështu jobindës në pretendimet e tij.

17.2 Kolegji vëren se, pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit para Komisionit për të riçelur hetimin administrativ dhe pyetjen e dëshmitarëve, në datën 16.04.2019 është mbajtur procesverbali për marrjen e deklarimeve të z. B. Gj., noteri që ka hartuar aktmarrëveshjen për premtim shitjeje, i cili i pyetur për këtë çështje nga Komisioni në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, ndër të tjera ka deklaruar: *Vlera 28.000 euro ka qenë vullneti i tyre çfarë ata dëshironin të shkruanin, nuk ka lapsus, por është shprehje e palëve. Këtë aktmarrëveshje e ka lexuar sepse e kam detyrim dhe nëse ato, palët, nuk kanë qenë të koncentruara në atë që kam lexuar, këtë nuk mund ta parashikoj. Tani flitej për 28.000 euro, sikur asgjë të mos binte në sy, kjo bie në sy. Vlera 28.000 euro nuk është lapsus, është vullneti i tyre.* Noteri, i pyetur disa herë nga komisionerët dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, nuk e ka pranuar nga ana e tij se jemi para një lapsusi të mundshëm të përfshirjes së kësaj shume (28.000 euro) në kontratë, por i qëndron vullnetit të palëve për vendosjen e shumës, madje ka deklaruar se të tre ishin juristë dhe e kuptonin rëndësinë e aktit konsensual që nuk kishte pse të vihej në dyshim, pohon deklaruesi.

17.3 Në procesverbalin për marrjen e deklarimeve të z. D. B., të mbajtur më datë 12.04.2019, i pyetur nga komisionerët dhe vëzhguesi ndërkombëtar për marrëdhënien kontraktuale me subjektin

e rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] ajo ishte një kontratë premtimi [...] Kjo është e vërtetë dhe e deklaroj nën përgjegjësinë time dhe nuk ma ka kryer këtë pagesë prej 28.000 eurosh. Kjo ishte arsyeja e kredisë dhe aktmarrëveshjes [...]. Shkëlzeni, në momentin që nuk ia miratuan kredisë, atëherë unë vazhdova me kompaninë. Kjo nuk është kontratë e bërë ashtu siç duhej, por ai nuk e mori kredisë dhe unë e zgjidha me firmën. I pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar se ky akt noterial gënjen që Cena të pagoi ty 28.000 euro, pra në prani të noterit publik ju keni bërë një akt që nuk është i vërtetë, z. B. është përgjigjur se: Po, por noterit ia kemi thënë jashtë zyrës, me idenë që Shkëlzeni mendonte që do ta merrte kredisë. E kuptoj edhe unë tani që është gabim.

Siç vërehet në këtë procesverbal, D. B nuk e pranon faktin që kësti prej 28.000 eurosh i është paguar nga subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që pranon se është nënshkruar një akt noterial fiktiv, i cili ka pasur qëllim marrjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit.

17.4 Kolegji konstaton se dëshmia e z. D. B bie ndesh me dëshminë e noterit, i cili pohon se akti ishte i vërtetë, duke sjellë në vëmendje se të tre të pranishmit ishin juristë që kuptojnë rëndësinë e një akti noterial dhe efekteve juridike të tij dhe, për më tepër, se akti u ishte lexuar me zë të lartë të pranishmëve nënshkruar. Fakti i citimit të shumës prej 28.000 eurosh, e cila përkon me shumën që z. D. B kishte dhënë për apartamentin e tij, përjashton mundësinë e lapsusit nga ana e noterit, si dhe parashikimet në të ashtuquajturat kontrata tip, të cilat mund të kenë ngjashmëri në kushtet që përmbajnë, por në këtë rast flitet për një shumë e cila përkon saktësisht me atë për të cilën duhej të arrihej qëllimi i blerjes sipas kushteve të kontratës dhe që ishte parapagesa e kështit të parë. *Sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, se ai nuk ka paguar vlerën 28.000 euro, është jobjindës dhe gjendet i pabazuar.*

- 18.** Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij pretendon se, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (në vijim "ligji nr. 9049/2003") i ndryshuar, nuk ka pasur detyrimin ligjor për ta deklaruar këtë veprim, duke qenë se nuk është paguar asnjë vlerë nga ana e tij. Në kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.04.2007, lidhur mes shtetasit D. B dhe shoqërisë "{***}" për pronësinë e apartamentit 2+1, është shkruar dhe është shprehur qartë se revokohet kontrata e porosisë me nr. {***} rep., datë 17.03.2006, çka ka bërë të revokueshme edhe aktmarrëveshjen e datës 11.07.2006, si pjesë e saj. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

18.1 Në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.04.2007, lidhur midis shtetasit D. B dhe shoqërisë "{***}" ShPK, për porosinë e apartamentin 2+1, në fund të nenit 7 është cituar shprehimisht: *Palët deklarojnë se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.03.2006, lidhur midis "{***}" ShPK dhe D. B shfuqizohet, palët i kanë shlyer detyrimet karshi njëri-tjetrit (pasi sipërmarrësi ia ka kthyer porositësit të gjitha kështet e paguara prej tij) dhe, si pasojë, kjo kontratë nuk sjell më asnjë pasojë juridike midis tyre.*

Fakti që D. B ka nënshkruar një kontratë tjetër me shoqërinë "{***}", nuk e revokon automatikisht aktmarrëveshjen e subjektit të rivlerësimit me z. B.. Parashikimi në pikën 7 të kontratës së sipërmarrjes së cituar më sipër, vlen vetëm për kontratën e z. B. me shoqërinë "{***}", për revokimin e së cilës nevojitej të parashikohej dhe të pranohej nga palët në rrugë kontraktore, çka nënkupton se marrëdhëniet kontraktuale monetare nuk mund të shuhen në heshtje, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, për sa kohë përmbajnë në to detyrime ende të pashlyera. Si rrjedhojë, edhe

aktmarrëveshja e subjektit të rivlerësimit me z. B. nuk mund të shuhej në heshtje, pasi nenet përbërëse të kësaj marrëveshjeje sillnin të drejta dhe detyrime për palët dhe, si e tillë, ose do të ekzekutohej në kuptim të pagesave, ose do të revokohej me një akt tjetër noterial që do sillte shuarjen e marrëveshjes ndërmjet tyre, por gjithsesi në asnjërin rast nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për deklarimin e marrëdhënies kontraktuale. Edhe nëse do të qëndronte pretendimi i subjektit të rivlerësimit për revokimin e kontratës, kjo rrethanë nuk e zhbën faktin e deklaruar në kontratën mes tij dhe B. për pagimin e 28000 eurove, pagesë për të cilën subjekti kishte edhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas analizës financiare që do të trajtohet në vijim.

18.2 Kolegji, pasi e gjeti të pabazuar në prova dhe në ligj këtë shkak ankimi, vlerëson se në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet e deklarimit detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, ku në germën “dh” të këtij neni përfshin si detyrime financiare ato ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj. Si rrjedhojë e këtij parashikimi ligjor, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e interesave privatë pasurorë (në vijim “DIPP”) të vitit 2006 kontratën e porosisë, shlyerjen e vlerës prej 28000 eurosh sipas mënyrës së pagesës së përcaktuar në aktmarrëveshje, si dhe detyrimin financiar që i kishte shoqërisë së ndërtimit për vlerën e mbetur nga totali i vlerës së apartamentit, por kjo pasaktësi e evidentuar nga Kolegji nuk mund të kualifikohet në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

18.3 Në Kolegji u krye analiza financiare për mundësinë e subjektit të rivlerësimit për pagesën e vlerës 28000 euro. Për vitin 2006, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit kanë qenë në vlerën 2988.309 lekë, të përbëra nga të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, të ardhurat nga kreditë e marra këtë vit në Raiffeisen Bank dhe Bankën Kombëtare Tregtare. Shpenzimet për subjektin e rivlerësimit, për këtë vit, janë përllogaritur në vlerën 806.401 lekë, të përbëra nga shpenzimet e jetesës, shpenzimet për udhëtime dhe shpenzimet për pagesa këstesh kredie. Në këtë vit janë përllogaritur pagesat për blerjen e një automjeti në vlerën 400.000 lekë dhe pagesa e përshkruar në kontratën noteriale në vlerën 28.000 euro. Në analizë janë përfshirë ndryshimet e gjendjeve të llogarive bankare dhe kursimi i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si kursim *cash* në banesë, në vlerën 1.000.000 lekë. Nga diferenca, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të përballonte krijimin e pasurisë automjet të blerë në këtë vit në shumën 400.000 lekë, pagesën e këstit të apartamentit në vlerën 28.000 euro, si dhe krijimin e kursimeve, pasi rezulton me një vlerë negative prej 2.566.449 lekësh. *Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim është jobindës dhe gjendet i pabazuar.*

Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit lidhur me pagesën e vlerës 28000 euro sipas aktmarrëveshjes për premtim shitje, nga sa rezultoi e provuar për këtë pasuri, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara deri në vitin 2006, gjithashtu rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të palës kontraktore shumën prej 28000 eurosh.

19. **Lidhur me mjetin “autoveturë Volkswagen”**, tipi “Passat”, viti i prodhimit 2006, regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, blerë me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 03.10.2009, në vlerën 1.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se përfundimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka njohur dhe ka pranuar dy akte noteriale me elemente të ndryshme nga njëri-tjetri për të njëjtin objekt shitjeje, duke cenuar etikën e prokurorit, është i pabazuar në fakte, në prova dhe në ligj. Sipas subjektit të rivlerësimit, automjeti është blerë me kredi sipas dokumenteve të administruara në dosje. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

19.1 Në **DIPP-në e vitit 2009**, është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit blerja e automjetit e tipit “Volkswagen” me targë {***}, me vlerë 1.000.000 lekë, në pjesë takuese 100%.

19.2 Në **deklaratën vetting**, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit autoveturë “Volkswagen”, tipi “Passat”, e vitit 2006, me targë {***}, regjistruar në emër të bashkëshortes së tij, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 03.10.2009, në shumën 1.000.000 lekë. Detyrimi doganor: në vlerën 294.172 lekë, me burim krijimi kredi sipas kontratës së kredisë nr. {***}, datë 09.11.2009, marrë në “Credins Bank” ShA. Pjesa takuese: 50%.

19.3 Kolegji vëren se me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2009, nënshkruar në një zyrë noterie në Tiranë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë këtë automjet nga shtetasja D. T., në shumën 1.000.000 lekë. Në praktikën që i përket këtij automjeti, dërguar në Komision nga DPSHTRR²⁵-ja, ka rezultuar se me kontratën tjetër të shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, nënshkruar në një zyrë noterie në Kukës, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë nga shtetasja D. T. (me banim në Amerikë) të njëjtin automjet në vlerën prej 6000 eurosh, shumë të cilën blerësi, sipas kësaj kontrate, e ka likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga verifikimi nga ana e Komisionit të sistemit TIMS, ka rezultuar se shtetasja D. T. ka dalë nga aeroporti i Rinasit në datën 08.10.2009, në orën 5:50, pra një ditë para nënshkrimit të kontratës në zyrën e noterisë në Kukës.

19.4 Në praktikën e Credins Bank rezulton se subjekti i rivlerësimit, me kontratën e kredisë nr. {***}, datë 09.11.2009, kishte marrë hua shumën 1.200.000 lekë, me afat 60 muaj, me qëllim blerje makine dhe mobilim shtëpie. Kredia rezultoi të ishte marrë me qëllim blerjen e automjetit, pasi nga llogaria e Credins Bank, rezultoi se kredia ishte disbursuar në datën 09.11.2009, në shumën 1.188.000 lekë, e cila ishte tërhequr në datën 12.11.2009.

19.5 Lidhur me këto mospërputhje kontratash dhe vlerash të blerjes së mjetit, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 05.02.2019, në Komision ka shpjeguar se: *Është e vërtetë se sipas konstatimit tuaj, kredia është marrë pas nënshkrimit të kontratës për blerjen e mjetit, më datë 03.10.2009, nga bashkëshortja ime, por kjo ka ndodhur sepse nga ana e bankës për marrjen e kredisë në atë kohë, më është kërkuar që të lidhja kontratën për blerjen e automjetit paraprakisht. Ndodhur në këto kushte, ne kemi rënë dakord me shitësen e makinës, shtetasen D. T., që kontratën ta lidhnim paraprakisht dhe likuidimin ta bënim pas marrjes së kredisë, siç edhe ka ndodhur. Atëherë, ishte rutinë që nga ana e noterit, në kontratë të shkruhej se palët janë likuiduar për shumën, por në të vërtetë, likuidimi i shumës nuk është bërë ditën e hartimit të kontratës. Në lidhje me vlerën reale të mjetit, është vlera e deklaruar në kontratën e shitjes. Në lidhje me faktin se vlera e deklaruar te banka ka qenë më e madhe se vlera e mjetit, kjo ka ndodhur*

²⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

për shkak se mjeti kishte nevojë për riparime, si dhe një pjesë e këtyre të ardhurave do të përdorej për taksat e mjetit dhe për kalimin e pronësisë së këtij mjeti në emrin e bashkëshortes. Pra, për t'iu përgjigjur përfundimisht edhe pikës së fundit të pyetjes, kredia e mësipërme e marrë në Credins Bank, është përdorur e gjitha për blerjen e automjetit tip “Volksvagen”, targimin dhe shërbimet e tij.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak, ka sqaruar në pyetësonin e datës 15.03.2019, në Komision se: *Sipas deklaratës doganore me nr. {***}, datë 09.10.2009, më rezulton se shuma e përgjithshme e detyrimit doganor (vlera e zhdoganimit) ka qenë 294.172 lekë. Kjo shumë detyrimi ka rezultuar nga llogaritjet e punonjësve të doganës, bazuar në referencat doganore. PAGESA është bërë nga ana ime, pasi shuma e blerjes së makinës prej 1.000.000 lekësh, përfshinte vlerën e makinës me targa të huaja dhe transportin e saj, dhe jo doganën. Kujtoj se së bashku me mua ka qenë edhe bashkëshortja ime dhe shtetasja D. T., meqenëse do të shkonim për Kukës, ku unë jetoja, ajo ka ardhur me ne edhe për të parë Kukësin, edhe që makina të provohej nga ana ime për gjendjen e saj teknike.*

19.6 Siç rezulton nga faktet dhe provat që gjenden në dosjen e përcjellë nga Komisioni, kemi praninë e dy kontratave të shitblerjes së automjetit objekt ankimi, të cilat rezultojnë të nënshkruara në zyra të ndryshme noterie në qytete të ndryshme (Tiranë, Kukës), me vlere të ndryshme blerjeje (1.000.000 lekë, 6000 euro), nënshkruar në data të ndryshme me diferencë në kohë rreth një javë. Lidhur me shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë për çmimin variabël në dy kontratat e shitblerjes së automjetit dhe vlerës së marrë kredi, janë bindëse, pasi kredia është marrë për qëllim të blerjes së automjetit, ku çmimi i blerjes së mjetit është i përafërt me vlerën e disbursuar të kredisë së marrë në Credins Bank, si dhe përkon koha e marrjes së kredisë me blerjen e mjetit. Kolegji, në përfundim të analizës së tij, e vlerësoi këtë situatë faktike si të pamjaftueshme për t'u kualifikuar sipas kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- 20.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni arrin në përfundimin e gabuar se kontrata e shitblerjes së automjetit tip “Volksvagen”, e datës 03.10.2009, me vlerën 1.000.000 lekë, është bërë në një moment kur automjeti nuk kishte hyrë ende në territorin e Shqipërisë, me arsyetimin se, sipas deklaratës doganore, ka hyrë në Shqipëri në datën 09.10.2009, në një kohë që automjeti ka qenë në Shqipëri që në datën 15.04.2009, sipas vërtetimit doganor. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ngatërron dokumentet duke e quajtur si të hyrë datën e zhdoganimit të mjetit, por, sipas tij, në atë kohë, mjetet mund të zhdoganoreshin në çdo zyrë doganore të vendit tonë.

Në analizë të këtij shkakut ankimi, rezultoi si më poshtë.

20.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni që gjendet në dosjen e përcjellë nga Komisioni, rezulton se në datën 15.04.2009, automjeti tip “Volksvagen”, me targë {***}, ka hyrë në Doganën e Hanit të Hotit, provuar kjo me dokumentin “vërtetim hyrje” me nr. serie {***}. (Në këtë vërtetim është vënë shënimi: “Mjeti është ngarkuar nga trajleri me targë [...]”). Më datë 09.10.2009, mjeti është zhdoganuar në Doganën e Morinës, ku është paguar edhe vlere e përcaktuar në faturë (294.172 lekë). Nga këto dy dokumente, del qartë momenti i hyrjes së mjetit në territorin shqiptar, si dhe momenti i pagesës së zhdoganimit të mjetit. Si rezultat, konstatimi i Komisionit se mjeti ka hyrë në Shqipëri më datë 09.10.2009, datë kjo, pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, është i gabuar, pasi kjo datë është e zhdoganimit të mjetit dhe jo e hyrjes së tij në Shqipëri. *Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjendet i bazuar.*

20.2 Sa i përket analizës financiare të kryer në Kolegj për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie, autoveturë e tipit “Volksvagen”, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës në vitin 2009 dhe se problematikat e kësaj çështjeje që janë konstatuar gabimisht nga Komisioni, nuk mund të kualifikohen në grupin e pasaktësive me pasojë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në këtë rast, duke i bërë këto të dhëna/fakte jorelevante për t’u kualifikuar dhe konsideruar në nivelin dhe llojin e marrjes së një mase disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

21. Lidhur me të ardhurat e shtetasit D. B., subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, e ka konsideruar këtë shtetas si person që përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur me të, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit ka pohuar në vitet 2011 dhe 2012 që e ka përdorur këtë pasuri me qira pa kundërshtim, çka nënkupton se ka hyrë në një marrëdhënie interesi pasuror dhe, si rrjedhojë, ka kërkuar dokumente dhe shpjegime lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie nga ai. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka qenë në marrëdhënie të interesit pasuror me shtetasin B. për një vit e gjysmë që nuk kanë formalizuar kontratën e qirasë, sepse ai nuk ishte bërë ende pronar i apartamentit, por ishte porositës i tij.

Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

21.1 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ishte regjistruar në Gjendjen Civile, Njësia Administrative nr. {***}, rruga “{***}”, Tiranë dhe në rubrikën “vendqëndrim tjetër, adresë e plotë ku banoni”, ka deklaruar: “Lagjja nr. {***}, pallati {***}, Kukës”.

21.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ishte regjistruar në Gjendjen Civile, Njësia Administrative nr. {***}, Tiranë, me adresë vendbanimi: rruga “{***}”, pallati {***}, Tiranë, kurse në rubrikën “vendqëndrim tjetër, adresë e plotë ku banoni”: lagjja nr. {***}, p. {***}, Kukës.

21.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se z. D. B ka porositur këtë apartament (2+1) me kontratën e porosisë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.04.2007 (apartament të cilin subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar se banon me qira), për të cilin ka parapaguar këstin e parë në shumën 47.500 euro në këtë datë. Nga dokumentacioni në dosje, rezulton se ky apartament ka qenë i regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK prej datës 08.06.2010, bazuar në vërtetimin hipotekor të datës 25.10.2011. Në datën 17.02.2012, rezulton se me kontratën e shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., D. B ka blerë këtë apartament për shumën 58.500 euro, me sipërfaqe 87,2 m². Sipas deklarimeve periodike, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë banimin me qira në deklaratën periodike të vitit 2010. Ndërkohë, rezultojnë në dosje kontrata qiraje që nga viti 2013 e në vazhdim.

21.4 Komisioni, me pyetësorin e datës 25.02.2019, ka kërkuar që subjekti të rivlerësimit të deklaronte se ku kishte jetuar në vitet 2006 – 2013, si dhe të deklaronte marrëdhënien që kishte pasur me adresën e banimit, të mbështetur në dokumentacion ligjor. Në përgjigje të këtij pyetësi, ai ka shpjeguar se: *Nga viti 2006 deri në muajin shtator të vitit 2010, unë më familjen time kemi jetuar në Kukës. Nga tetori 2010, deri në mars të vitit 2011, djali im, G. C., ka jetuar në apartamentin në lagjen nr. {***} në Kukës, pasi unë kam punuar në Prokurorinë e Rrethit*

Gjyqësor Kukës nga viti 1998-2012. Në tetor të vitit 2010, kur dhe bashkëshortja u largua nga puna, e kemi sjellë djalin në Tiranë për të vazhduar shkollën [...] ka jetuar në shtëpinë e kunatës sime. Në mars të vitit 2011, kur bashkëshortja filloi punë në Tiranë, kam biseduar me shokun tim, z. D. B., i cili më ka dhënë pa qira apartamentin ku sot banoj aktualisht me qira, siç ju kam shpjeguar, ashtu të pamobiluar. Nga dokumentacioni që ndodhet në dosje, përveç sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit lidhur me periudhën e banimit pa qira në banesën e shtetasit D. B., ky i fundit, në cilësinë e qiradhënësit, ka lidhur disa kontrata qiraje me subjektin e rivlerësimit për këtë apartament nga viti 2013 e në vazhdim, për të cilat është paguar edhe tatimi mbi qiranë.

21.5 Komisioni, në analizë të fakteve, se subjekti i rivlerësimit i) e ka deklaruar këtë pasuri si adresë të gjendjes civile prej viti 2010; ii) si adresë banimi prej vitit 2011; iii) ka pohuar se në vitet 2011 dhe 2012 e ka përdorur këtë pasuri me qira pa kundërshpërblim, çka nënkupton se ka hyrë në një marrëdhënie interesi pasuror, ka vlerësuar se shtetasi D. B. përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur, bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, sipas Komisionit, ai kishte detyrimin të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

21.6 Në analizë të dispozitave më lart, përcaktimet e bëra në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, janë referime që duhet të përdoren për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur, por edhe për t'u përdorur nga institucionet për të përcaktuar e parandaluar gjendjen e konfliktit të interesit, krahas legjislacionit të posaçëm që rregullon situatën e konfliktit të interesit për zyrtarët.

21.7 Në të njëjtën linjë me këtë arsyetim shkon edhe analiza e rregullit të vendosur në shtojcën nr. 2, që shoqëron ligjin nr. 84/2016, sipas së cilës: *Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme”. Kjo dispozitë duket se qëndron në harmoni me parashikimet që bën neni 3, pika 11 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, sipas së cilës: *Person i lidhur me një zyrtar është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.**

21.8 Në analizë të kësaj situate²⁶ ligjore, nga Kolegji arsyetohet se parashikimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situate të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-

²⁶ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, paragrafët 107, 108, 109; nr. 20/2019 (JR), datë 08.09.2020, paragrafi 21.3.*

ja (shih nenin 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi, legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi.

Në këto kushte, pavarësisht disa rrethanave të konstatuara në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nga z. D. B., i cili nuk duhej të merrej në analizë nga Komisioni, pasi nuk është në rrethin e personave të tjerë të lidhur, siç u sqarua më lart, të gjendur në kushtet e mungesës së dyshimeve për konflikt të mundshëm interesi apo pasuri të fshehura, vlerësohet se verifikimi i mëtejshëm i tyre do të kapërcente kufijtë e objektit të procesit të rivlerësimit. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet e panevojshme të hetohet më tej për burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi 2+1, në pronësi të shtetasit D. B.

22. **Lidhur me mjetin “autoveturë Opel Corsa”**, subjekti i rivlerësimit pretendon se autovetura është blerë në datën 23.02.2014 dhe Komisioni ka kryer një analizë financiare për periudhën pasi është blerë kjo autoveturë. Sipas tij, nga fundi i muajit qershor 2013 deri një vit më pas, bashkëshortja e tij është paguar nga sigurimet shoqërore sepse ka qenë me leje lindjeje dhe këto të ardhura, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk janë përlllogaritur nga Komisioni. Ai pretendon se në analizën financiare janë përlllogaritur nga ana e Komisionit shpenzimet e jetesës për 4 persona, por në fakt subjekti i rivlerësimit pretendon se personi i katërt, vajza e tij, ka lindur në datën 10.07.2013 dhe është trajtuar me shpenzime njësoj si një i rritur, edhe pse ushqej vetëm me gjirin e nënës. Në analizë të këtij shkaku ankimi, arsyetohet si më poshtë.

22.1 Kolegji sjell në vëmendje se shpenzimet e jetesës së përlllogaritura nga institucionet e statistikave, përdorur për referencë edhe në analizën përkatëse, nuk kanë një ndarje sipas grupmohës, por sipas numrit të pjesëtareve të familjes. Pavarësisht moshës së vogël së fëmijës, shpenzimet e përlllogaritura për të janë ato shpenzime të cilat shkojnë për nevoja të rritjes së fëmijës, të cilat nuk lidhen detyrimisht me ushqimin e fëmijës. Në analizën e Kolegjit, shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit janë përlllogaritur bazuar në përbërjen familjare të tij vit pas viti, siç është deklaruar në deklaratimet periodike të pasurisë.

22.2 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit për vitin 2014 nuk ka pasur të ardhura financiare për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe krijimin e pasurive edhe duke përdorur për referencë të dhënat e dy faturave të zhdoganimit, të cilat me të njëjtin numër reference paraqesin vlera të ndryshme të zhdoganimit të automjetit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013 kursime në fund të vitit. Në analizën financiare janë përshirë të ardhurat e bashkëshortes së tij nga Sigurimet Shoqërore për pagesën e lejes së lindjes. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente blerjen e kësaj pasurie deri fund të muajit shkurt 2014 për vlerën -111.643 lekë.

23. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit se ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për zhdoganim, është i pabazuar në analizën e dokumenteve të paraqitura dhe nuk mund të jetë penalizues për të. Sipas tij, fatura e zhdoganimit të mjetit është bërë mbi bazën e dokumenteve të mjetit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se dogana ka vendosur në dy fletët e zhdoganimit me nr. {***} vlera statistikore të ndryshme, duke iu referuar çmimit të referencës. Të dyja këto fletë janë paraqitur së bashku me deklaratën *vetting* dhe nuk mund të penalizohet subjekti i rivlerësimit për një gabim të punonjësit të doganës në përpilimin e dokumenteve.
Në analizë të këtij shkak, ankimi Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

23.1 Në lidhje me zhdoganimin e kësaj autoveture “Opel Corsa”, në dosjen e DPSHTRR-së rezultojnë dy fatura zhdoganimi për të njëjtën autoveturë, me të njëjtin numër reference ({***}), si dhe të së njëjtës datë (27.02.2014), sipas të cilave njëra ka vlerë zhdoganimi 18256 lekë, aq sa e ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, ndërsa tjetra në vlerën 24212 lekë. Për qartësimin e kësaj situate lidhur me vlerën reale të paguar për zhdoganimin e automjetit, nevojitej të verifikohet në sistemin elektronik të doganave se cila është fatura e regjistruar në këtë rast, për të vlerësuar më tej lidhur me saktësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimit, ndaj kjo pjesë e çështjes mbetet e paprovuar nga subjekti i rivlerësimit dhe e pahetuar më tej nga Komisioni. Kolegji për të qenë garantist dhe eficient kreu dhe u mjaftua me analizën financiare për vitin 2014, nga ku subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të të ardhura për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe krijimin e pasurive edhe duke përdorur respektivisht për referencë vlerat e të dyja faturave të zhdoganimit.

Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë autoveturën “Opel Corsa”, nga sa rezultoi e provuar për këtë pasuri, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar blerjen e kësaj autoveture, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në vitin 2014.

24. Në lidhje me pasurinë “tokë bujqësore”, ndodhur në Kolonjë, Lushnjë, pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me prindërit e saj, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, pas hetimit ka arritur në përfundimin se nuk i rezultuan dyshime mbi ekzistencën e kësaj pasurie dhe se përputhet deklarami i tij me dokumentacionin e administruar në dosje dhe, për këtë arsye, përfundimi i Komisionit i arritur në vlerësimin tërësor të çështjes, për sa i përket pasurisë dhe në lidhje me këtë pasuri, duhet të rrëzohet nga Kolegji si i pabazuar në prova dhe në ligj.
Në analizë të këtij shkak ankimi, rezultoi si më poshtë.

24.1 Kolegji vëren se, bazuar në vërtetimin nr. {***} prot., datë 24.02.2016, të Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës Kolonjë, vërtetohet se familja e z. O. T. ka përfituar tokë bujqësore me sip. 23294 m² nga zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në z.k. nr. {***}. Bashkëlidhur vërtetimit është certifikata familjare e datës 24.02.2016, ku në datën 01.08.1991, në përbërjen familjare të z. T. ka qenë edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

24.2 Siç vërehet edhe nga konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri, konkludohet se përputhet deklarami i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosje, po ashtu edhe në rezultatet e hetimit të parë, datë 25.03.2019, Komisioni nuk ka kaluar barrë prove pikërisht për këtë arsye, ndërsa në vlerësimin tërësor të çështjes, në fund të vendimit objekt shqyrtimi, e ka cituar si pasuri të kategorizuar si deklaram të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit. Kolegji,

në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

25. **Lidhur me shkaqet e ankimit për analizën financiare** të viteve 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai ka pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera në këto vite me burime financiare të deklaruara dhe të dokumentuara, në total në vlerën 3.880.003 lekë, është i gabuar, i pasaktë, i pabazuar në fakte dhe dokumente, por i kryer mbi baza statistikore dhe jo dokumentare. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

25.1 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, kanë rezultuar këto përfundime: për vitin **2006** (detajuar në paragrafin 18.3 më sipër) rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të përballonte krijimin e pasurisë automjet, pagesën në vlerën 28.000 euro dhe krijimin e kursimeve për një diferencë negative në vlerën 2.566.448,57 lekë.

25.2 Për vitin **2011**, nga analiza financiare rezultoi se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga pagat e tij dhe të bashkëshortes kanë qenë në vlerën 1.382.446 lekë. Shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për vitin 2011, të përbëra nga shpenzimet e jetesës, udhëtimit, arredimit dhe pagesat e kësteve të kredisë, kanë qenë në vlerën 1.397.811 lekë. Për këtë vit, janë përlllogaritur ndryshimi i gjendjes së likuidimeve nga llogaritë bankare në fillim dhe në fund të vitit. Nga diferenca, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte shpenzimet e jetesës për këtë vit për një diferencë negative në vlerën 39.629 lekë.

25.3 Për vitin **2013**, nga analiza e kryer në Kolegj, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të përbëra nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, kanë qenë në vlerën 1.626.840 lekë. Shpenzimet e jetesës, udhëtimit, arredimit, shpenzimet e pagesave të qirasë dhe shpenzimet për pagesat e kësteve të kredisë ishin në vlerën 1.754.483 lekë. Për këtë vit, janë përlllogaritur ndryshimet e gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e pasurisë dhe përballimin e shpenzimeve për një diferencë negative në vlerën 100.982 lekë.

25.4 Për vitin **2014**, nga analiza financiare, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga paga e tij dhe e bashkëshortes, kanë qenë në vlerën 1.442.804 lekë. Për këtë vit, rezulton se ai ka kryer blerjen e një automjeti, vlera e të cilit së bashku me zhdoganimin ka qenë në vlerën 94.267 lekë. Shpenzimet e jetesës, shpenzimet e qirasë, shpenzimet e pagesës së energjisë elektrike në vlerën 480.000 lekë dhe shpenzimet e pagesave të kësteve të kredisë për këtë vit kanë qenë në vlerën 2.236.479 lekë. Për këtë vit janë përlllogaritur edhe ndryshimet e gjendjes së llogarive bankare. Nga diferenca e të ardhurave me shpenzimet, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e pasurisë dhe përballimin e shpenzimeve për një diferencë negative në vlerën 909.073,82 lekë.

25.5 Për vitin **2015**, nga analiza financiare rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit kanë qenë në vlerën 1.325.586 lekë. Shpenzimet e jetesës, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e arredimit dhe shpenzimet e pagesave të kësteve të kredisë kanë qenë në vlerën 1.330.788 lekë. Për këtë u përlllogaritën edhe ndryshimet e gjendjeve të likuiditeteve në llogaritë bankare. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në banesë në vlerën 200.000 lekë. Nga diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e pasurisë dhe përballimin e shpenzimeve për një diferencë negative në vlerën 132.283 lekë.

Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, nga sa rezultoi e provuar dhe e analizuar në Kolegj, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara për vitet 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, për një diferencë negative në vlerën 3.748.416 lekë.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

26. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka bërë rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar, por jo vetëm, në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga KLP-ja me nr. {***} prot., datë 13.05.2019. Gjatë analizimit të këtij raporti, Komisioni ka konstatuar, sikurse edhe KLP-ja, disa problematika në një prej dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në tri nga pesë dosjet e përzgjedhura me short. Në analizë të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Kolegji konstaton si më poshtë.
27. ***Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012***, një nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit për t’iu nënshtruar vlerësimit profesional, është me titull “diskutime përfundimtare” në këtë procedim. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, se ai nuk depozitoi prova për të provuar se transferimi ishte kryer me kërkesë të të pandehurve, është i pabazuar në ligj. Asnjëherë gjatë hetimit, Komisioni nuk i ka kërkuar të paraqesë prova se përse çështja gjykohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ashtu sikurse ka vepruar në çdo rast, edhe në çështje të tjera të ngjashme gjatë hetimit administrativ, Komisioni duhet të kërkonte vetë çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të studionte dosjen dhe të arrinte pastaj në konkluzionet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky moment procedural, konsumohet në fillim të çeljes së shqyrtimit gjyqësor. Në analizë të këtij shkaku ankimi, rezultoi si më poshtë.

27.1 Kolegji vëren se nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit (diskutimit përfundimtar), në raportin e KLP-së është konstatuar se disa herë nuk janë respektuar me korrektësi rregullat e drejtshkrimit, fjalitë hera-herës paraqiten edhe të paqarta, përmbajnë referenca ligjore, por gjuha e përdorur jo gjithnjë është juridike, në mënyrë të veçantë sa u përket provave dhe fuqisë së tyre provuese. Dokumenti paraqitet disi i strukturuar, disa herë prokurori përdor edhe gjuhë emotive. Pjesët e këtij dokumenti janë të ndara, paragrafët janë të ndarë. Nga ana e prokurorit të çështjes, që është subjekti i rivlerësimit, nuk shpjegohet arsyeja se përse diskutimi përfundimtar zhvillohet para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që procedimi penal është hetuar nga ana e Prokurorisë Kurbin.

27.2 Kolegji vëren se në dosjen profesionale, lidhur me këtë procedim penal gjendet vetëm dokumenti “diskutimi përfundimtar mbi gjykimin e çështjes nr. {***}”, nga pjesa hyrëse e të cilit rezulton se ky dokument i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa nga teksti i dokumentit në pjesën përshkruese, subjekti i rivlerësimit ka referuar se ngjarja ka ndodhur në Fushë-Mamurras dhe se procedimi penal është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Kurbin. Në diskutime përfundimtare, nuk rezulton i pasqyruar ky moment procedural, se përse subjekti i rivlerësimit po përfaqësonte organin e akuzës në një tjetër qytet nga ai ku ishin kryer hetimet.

27.3 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës 05.06.2019, që ka dhënë pas rezultateve të hetimit nr. 2 pas riçeljes së hetimit administrativ, është shprehur se: [...] *kjo gjetje e Komisionit nuk mund të merret në disfavorin tim, pasi këtë fakt ua ka bërë me dije palëve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që në çelje të hetimit gjyqësor. Transferimi i çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku fillimisht ishte dërguar çështja për gjykim, dhe përcaktimi i gjykatës së shqyrtimit të çështjes ishte vendosur nga Gjykata e Lartë, me kërkesën e të pandehurve, të paraqitur para gjykatës dhe jo para prokurorit. Më pas, unë jam autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm për të përfaqësuar akuzën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

27.4 Konkluzioneve të raportit të KLP-së lidhur me këtë dokument (diskutim përfundimtar), u është referuar edhe Komisioni për vlerësimin e kësaj çështjeje, por nuk rezulton të ketë kërkuar dosjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të bërë verifikimin e situatës, si dhe për të kryer një vlerësim diktuar nga nevoja për kryerjen e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale se për çfarë arsyeje diskutimet përfundimtare janë dhënë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një kohë që ngjarja ka ndodhur në Mamurras dhe procedimi penal është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, si rrjedhojë kjo çështje mbetet e pahetuar nga Komisioni, në drejtim të qartësimit të rrethanave të kësaj mospërputhjeje lidhur me këtë procedim penal. Në konkluzion, Kolegji, rrethanat e konstatuara nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, nuk i kualifikoi të tilla për ta vlerësuar negativisht subjektin e rivlerësimit dhe për ta konsideruar si një shkelje që mund të kualifikohet në përputhje me përcaktimet e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

28. ***Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2015***, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimet e nxjerra nga Komisioni janë të pabazuara në ligj. Sipas tij, në asnjë rast në Kodin e Procedurës Penale, apo në ligjet e tjera ku është mbështetur vendimi, nuk parashikohet se në vendim duhen të pasqyrohen urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto gjetje të Komisionit janë të pabazuara dhe duhen të rrëzohen. Në analizë të këtij shkakui ankimi, rezultoi si më poshtë.

28.1 Procedimi penal është regjistruar për veprën penale *përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike*, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në këtë procedim penal, si një nga pesë dosjet e shortuara për kryerjen e vlerësimit profesional, objekt shorti është dokumenti ligjor vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Cena.

28.2 Kolegji vëren se në rezultatet e raportit të KLP-së për këtë çështje, është konkluduar se nga përmbajtja e aktit procedural “vendim pushimi” konstatohet se nuk janë respektuar drejt rregullat e drejtshkrimimit. Teksti disa herë nuk është i qartë dhe i kuptueshëm. Vendimi është ndërtuar në mënyrë skematike, sipas standardit të akteve të kësaj natyre, ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në vendim pasqyrohen rrethanat e faktit penal, por argumentimi *sui generis*, i bërë nga subjekti i rivlerësimit, nuk pasqyron veprimet hetimore në vijimësi dhe nuk përputhet me veprën penale për të cilën prokurori ka urdhëruar fillimin e procedimit penal.

28.3 Në dokumentin “vendim pushimi” të çështjes penale nr. {***} të vitit 2015, rezulton se ky procedim penal është regjistruar për veprën penale të “Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i K.Penal, veprë e cila ndiqet me ankimin e të dëmtuarit. Për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes bazuar në nenin 328,

pika 1, shkronja “c” e K.Pr.P, pasi i dëmtuari nga vepra penale ka hequr dorë nga e drejta e ankimit dhe organi i akuzës është vënë në lëvizje me kallëzimin e tij.

28.4 Në raportin e KLP-së, për pjesën konkluduese të vendimit të pushimit të procedimit penal, citohet se: *Në dokumentin “vendim pushimi”, subjekti i rivlerësimit ka analizuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, por nuk ka bërë asnjë analizë të figurës së veprës penale dhe arsyen pse kemi të bëjmë me dy vepra penale, saktësisht atë të “Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i K.Penal, dhe të “Fyerjes”, parashikuar nga neni 119 i K. Penal”.*

28.5 Kolegji vëren se në pjesën hyrëse të vendimit të pushimit konstatohet se procedimi penal {***} është regjistruar për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Më pas renditen rrethanat e ngjarjes ku rezulton se një person ka telefonuar kallëzuesin me numër të mbuluar, duke e përsëritur këtë gjë dhe duke e sharë në telefon. Policia, pasi merr kallëzimin e qytetarit, referon faktin te prokurori për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Në vendimin e pushimit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Në vlerësim të rrethanave të faktit dhe të ligjit, dy janë veprat penale të konstatuara: “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike” dhe “Fyerje” nëpërmjet telefonit, vepra këto të parashikuara nga nenet 275 dhe 119 të Kodit Penal, përderisa i dëmtuari është shqetësuar 2-3 herë në telefon dhe është fyer e sharë [...]. Në dispozitivin e vendimit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: Të pushojë çështjen penale nr. {***} të vitit 2015, për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal [...].*

28.6 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 05.06.2019, që ka dhënë pas rezultateve të hetimit nr. 2, ka shpjeguar se: *Përderisa kallëzuesi ka hequr dorë nga ankimi për veprën penale, vlerësohet se nuk është i nevojshëm analizimi i gjatë i elementeve të faktit, analizimi i gjatë i elementeve të figurave të veprave penale etj., pasi në momentin që i dëmtuari heq dorë nga ankimi, procedimi nuk mund të vazhdojë.*

28.7 Nga ana ligjore, bazuar në nenin 59, pika 1 e K.Pr.Penale, e cila parashikon: *Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, për rrjedhojë vepra penale e “fyerjes”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, vepër e cila përfshihet në rrethin e veprave të cituara në nenin më sipër, ndiqet nga viktimat akuzuese me kërkesë në gjykatë. Ndërsa vepra penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i K.Penal, kallëzohet në Prokurori ose Polici. Kjo duket se është arsyeja që subjekti i rivlerësimit jep, veç të tjerash, edhe në shpjegimet e rezultateve të hetimit nr. 2, por gjithsesi një gjë e tillë nuk del shumë qartë te vendimi dhe, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka cituar në vendim se për veprën penale të “fyerjes”, i dëmtuari mund t’i drejtohet gjykatës, arsyetimi i vendimit nuk duket shumë i qartë, pasi nuk ka shpjeguar në arsyetim se kjo vepër nuk është në kompetencë të prokurorit për ta hetuar e ndjekur penalisht. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, por nuk ka bërë asnjë analizë të figurës së veprës penale dhe arsyen pse kemi të bëjmë me dy vepra penale.*

28.8 Bazuar në nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon: *Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues*

të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, nga Kolegji konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e pushimit, ka mangësi në drejtim të qartësimit të pjesës arsyetuese të vendimit, duke bërë të pamundur kuptimin e lidhjes së këtyre dy veprave penale dhe pse janë cituar të dyja. Si rrjedhojë, lidhur me këtë dokument ligjor, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e paqartësisë në pjesën arsyetuese të dokumentit objekt shqyrtimi (vendim pushimi). Për sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

29. **Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2015**, subjekti i rivlerësimit pretendon se në pjesën konstatuese të vendimit është evidentuar fakti se për ndërtimin e shtesës prej 22 m² të lokalit, nuk mund të bëhet ndjekje penale për "Ndërtim të paligjshëm", bazuar në nenin 4 të K.Pr.Penale dhe në ligjet nr. 22/2014 dhe 92/2015, dhe jo për faktin e konstatuar më datë 24.07.2015, për të cilin ishte referuar materiali kallëzues, vendosja e vetratave prej duralumini dhe riparimi i fasadës së lokalit. Pikërisht për këtë fakt, është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi vendosja e dymëve dhe dritareve, punimet për riparim fasade objekti, vendosje reklamash etj., janë përjashtuar nga leja e ndërtimit, sipas VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, është parashikuar se: "Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet". Sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin në fjalë, Komisioni ka luajtur rolin e prokurorit duke zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e tij në arsyetimin e vendimit. Në analizë të këtij shkak ankimi, rezultoi si më poshtë.

29.1 Procedimi penal është regjistruar për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm", në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilin ai ka vendosur pushimin e procedimit penal. Në këtë procedim penal, si një nga 5 dosjet e shortuara për kryerjen e vlerësimit profesional, objekt shorti është dokumenti ligjor vendim "Për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, hartuar nga subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Cena.

29.2 Në raportin e KLP-së me nr. {***} prot., datë 15.05.2019, për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë procedim penal, është konkluduar se nga përmbajtja e aktit procedural "vendim pushimi", konstatohet se nuk janë respektuar drejt rregullat e drejtshkrimit. Teksti disa herë nuk është i qartë dhe i kuptueshëm. Vendimi është ndërtuar në mënyrë skematike sipas standardit të akteve të kësaj natyre, ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në vendim pasqyrohen rrethanat e faktit penal, por argumentimi *sui generis*, i bërë nga subjekti i rivlerësimit, nuk pasqyron veprimet hetimore në vijimësi. Gjithashtu, nuk evidentohet mënyra se si subjekti i rivlerësimit ka arritur në këtë konkluzion, se përse po në vendimin e pushimit, objektin "vetratë" e klasifikon si pjesë që nuk kërkon marrjen e një leje paraprake ndërtimi. Në vendimin e pushimit, subjekti i rivlerësimit shprehet se këto punime nuk mund të konsiderohen si ndërtim i paligjshëm në kuptim të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (në vijim "ligji nr. 107/2014"), i ndryshuar dhe, për rrjedhojë, edhe në kuptim të nenit 199/a të Kodit Penal.

29.3 Kolegji vëren se në dokumentin "Informacion për referimin e veprës penale te prokurori", datë 24.07.2015, hartuar nga oficeri i policisë gjyqësore, material i cili gjendet në dosjen e procedimit penal objekt shqyrtimi, referohet se: "Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, konstatohet se

në këtë dyqan janë bërë dy shtesa ndërtimi me dyqanin ekzistues në fasadën lindore dhe në fasadën jugore të tij në formë të germës “L”, kjo shtesë ndërtimi është e përfunduar dhe e mbuluar me soletë betoni, pjesa lindore dhe jugore e fasadës së këtij dyqani janë të mbyllura me xhama dhe duralumin”. Në aktet që ndodhen në fashikullin e procedimit penal të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se nga këqyrja në vendngjarje, janë bërë edhe foto të objektit, ku duket qartë se nuk është thjesht ndërrim vetratë, siç pretendon ai në shkakun e ankimit, por është ndërtim me vetratë dhe soletë.

29.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 05.06.2019, pas rezultateve të hetimit nr. 2, ka shpjeguar se: *Në pjesën konstatuese të vendimit, është evidentuar fakti se për ndërtimin e shtesës me sip. 22 m² të lokalit, nuk mund të bëhet ndjekje penale për “ndërtim të paligjshëm”, bazuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjeve nr. 22/2014 dhe nr. 92/2015, dhe jo për faktin e konstatuar në datën 24.07.2015, për të cilin ishte referuar materiali kallëzues, vendosja e vetratave prej duralumini dhe riparimi i fasadës së lokalit. Pikërisht për këtë fakt është vendosur pushimi i procedimit, pasi vendosjet e dyerve dhe të dritareve, punimet për riparim fasade objekti, vendosje reklamash etj., janë përjashtuar nga leja e ndërtimit. Në vendim është evidentuar mënyra se pse është arritur në konkluzionin se vendosja e vetratës prej duralumini (xham), si punim, nuk hyn në kategorinë e punimeve apo të ndërtimeve që kërkojnë leje ndërtimi, bazuar pikërisht në neni 6 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, ku përcaktohet se ndërhyrjet, si riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe i dyerve, i qepenave dhe i vitrinave etj., bëhen pa kërkuar leje ndërtimi.*

29.5 Në vendimin e pushimit të çështjes, rezulton se argumentohet fakti që nuk dihet koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa procedimi është pushuar pikërisht për shkak të ligjit të kohës “Për dhënie amnistie”. Sipas këtij ligji, është amnistuar ndjekja penale për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” për të gjitha ndërtimet e bëra pa leje deri më datën 10 prill 2014.

29.6 Kolegji, nëpërmjet vlerësimit të vendimit të pushimit të çështjes për këtë procedim penal, vëren se, nga njëra anë subjekti i rivlerësimit nuk e klasifikon objektin e kallëzimit si ndërtim pa leje në kuptim të ligjit nr. 107/2014, nga ana tjetër e cilëson faktin si vepër penale të amnistuar në kuptim të ligjit nr. 92/2015 “Për dhënie amnistie”, duke e pushuar çështjen bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b” e K.Pr.P., me arsyetimin se fakti i konstatuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Për pasojë, konstatohet se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsyetuese të vendimit, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi teksti i vendimit të pushimit të çështjes për këtë procedim penal, është i pakuptueshëm. Për pasojë, shkakun e ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

30. Lidhur me masën disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra**”, të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, në ankim u pretendua se, pavarësisht se ka dhënë shpjegime, rezulton se Komisioni ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore, duke marrë në shqyrtim këtë çështje, në kundërshtim me nenin 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku thuhet se: “Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale [...]”. Sipas tij, kjo çështje që lidhet me këtë masë disiplinore, nuk duhet të merret parasysh në vlerësimin tërësor të çështjes. Në analizë të këtij shkakun ankimi, rezultoi si më poshtë.

30.1 Kolegji vëren se nga analizimi i të dhënave të pasqyruara në raportin e KLP-së dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 02.06.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, kishte marrë masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, në kohën kur ai ushtronte funksionin e

prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për shkak të moskryerjes së disa veprimeve hetimore në një procedim penal të vitit 2003.

30.2 Për këtë informacion, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, ku ky i fundit ka shpjeguar se materiali kallëzues nga policia për çështjen për të cilën ai është penalizuar, kishte ardhur në afatet e fundit, pas arrestimit të personave, se materiali i përgjimit i ndodhur në dosje ishte sjellë jashtë afatit ligjor prej 24 orësh, se kërkesën për lejim përgjimi që ai i kishte bërë gjykatës, kjo e fundit nuk e kishte shqyrtuar pasi ishte dërguar me vonesë. Ai, po ashtu, është shprehur se për vleftësimin si të paligjshëm të kontrollit të një banese, ai kishte pasur bindjen e tij. Subjekti i rivlerësimit e përshkruan penalizimin e tij se ka ardhur për shkak se çështja kishte pasur impakt.

30.3 Në raportin e KLP-së, nga verifikimi i të dhënave me burime arkivore, lidhur me këtë masë disiplinore, raportohet se është dhënë në përfundim të procedimit disiplinor të filluar me urdhrin nr. {***}, datë 11.04.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku sipas veprimeve të para hetimore që lidhen me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2003, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 109, paragrafi 1 dhe 25 i Kodit Penal, prokurori Shkëlzen Cena nuk i ka paraqitur kërkesë gjykatës për vleftësimin e përgjimit konform nenit 222, pika 2 e K.Pr.P., gjithashtu ka shfuqizuar kontrollin në flagrancë të banesës së personit nën hetim, në shkelje të plotë të nenit 202, pika 3 e K.Pr.P.

30.4 Kolegji vëren se neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: *Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.* Procedimi penal i shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit i përket vitit 2003, gjithashtu masa disiplinore "vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" është vendosur ndaj tij në vitin 2005, pra procedimi penal rezulton jashtë periudhës së parashikuar me ligj për vlerësimin dhe kontrollin e aftësive profesionale. Në konkluzion, Kolegji, rrethanat e konstatuara nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, nuk i kualifikoi të tilla për ta vlerësuar negativisht subjektin e rivlerësimit dhe për ta konsideruar si një shkelje që mund të kualifikohej në përputhje me përcaktimet e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

31. Lidhur me praktikën nr. {*} të vitit 2014**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka konstatuar se ndaj vendimit të pushimit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2011 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, është ushtruar ankim në gjykatë, dhe çështja është në shqyrtim. Sipas tij, neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, mes të tjerash parashikon se “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që nuk janë në shqyrtim dhe, në këto kushte, është në kapërcim të kompetencave të tij, prandaj nuk duhet të merret parasysh në vlerësimin tërësor të çështjes. Në analizë të këtij shkak ankimi, rezultoi si më poshtë.

31.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji vëren se nga të dhënat e raportit të KLP-së, rezulton se shtetasi P. N. ka bërë dy kallëzime penale, çështje të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin qytetari ka pretendime se nuk ka kriteret e duhura për të qenë prokuror i çështjeve, pasi janë tejzgjatur hetimet. Njëri prej procedimeve penale rezulton të jetë pushuar dhe nuk është ushtruar ankim, ndërsa lidhur me kallëzimin tjetër është konstatuar se çështja është në shqyrtim gjyqësor në fazën përfundimtare. Kjo situatë është reflektuar e tillë edhe në konkluzionet e Komisionit, por nuk rezulton të jetë renditur apo adresuar kjo praktikë në vlerësimin tërësor të çështjes në

vlerësimin negativ të tij, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, ndaj ngritja e shkakut të ankimit ka qenë e panevojshme.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

32. DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Cena, me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Me kërkesën e Komisionit për përditësimin e këtij raporti, në vijim është përcjellë nga DSIK-ja raporti tjetër i rishikuar me nr. {***} prot., datë 19.12.2018, për kontrollin e figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 08.01.2019, sipas të cilit është vlerësuar për papërshtatshmërinë për vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit.
33. Në këtë raport të rishikuar është konstatuar se, bazuar në informacionin e ardhur nga institucioni i verifikimit, rezulton se disponohen të dhëna të viteve 2006 dhe 2010, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptuese në disa çështje penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës. Raporti i DSIK-së, veç të tjerash, ka informuar se:
- *Ngrihen dyshime për veprime korruptuese në sistemin e drejtësisë.*
 - *Në rastet e evidentuara të korrupsionit pasiv pranë gjyqësorit Kukës, subjekti i rivlerësimit dyshohet të jetë përfshirë në korrupsion pasiv të prokurorit në disa procese penale ndaj shtetasve të akuzuar për kontrabandë, duke i dënuar me gjopa të lehta, edhe kur veprat kanë qenë të përsëritura.*
 - *Gjatë vitit 2010, z. Shkëlzen Cena dyshohet të jetë përfshirë në një rast korrupsioni në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës, duke orientuar personin e pandehur për kryerjen e veprimeve të caktuara, me qëllim ndryshimin ose lehtësimin e akuzës ndaj tij.*
 - *Rasti i vitit 2010 e thekson edhe më tepër rolin në veprimtari të paligjshme të prokurorit Cena, pasi aty shfaqet një formë konkrete nëpërmjet së cilës ky prokuror ka abuzuar me detyrën për të realizuar favorizimin e të pandehurit, me qëllim përfitimin.*
 - *Ka dyshime të arsyeshme se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së tij.*
 - *Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.*
 - *Informacioni që disponohet në ngarkim të prokurorit Cena, për implikim në veprimtari korruptuese të funksionarit të drejtësisë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose për të mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.*
 - *Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta nga prokurori Shkëlzen Cena me palën/personin në fazën e hetimit apo gjykimin të një procedimi penal, është një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm, në shkelje të plotë të detyrës së tij funksionale.*
34. Komisioni, nisur nga gjetjet në raportin e KLP-së, dhe jo vetëm, por edhe nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës edhe dy dosje penale, përkatësisht të viteve 2006 dhe 2010, të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Këto dy procedime

penale (***} dhe {***}), që janë objekt ankimi, Komisioni i ka shqyrtuar dhe vijojnë si më poshtë.

- 35. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2006**, në ngarkim të të pandehurit M. K., i akuzuar për veprën penale “Kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, dënuar me 160.000 lekë gjobë me vendim të formës së prerë, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit se nuk ka depozituar aktin për zëvendësimin e tij në fazën e diskutimeve përfundimtare, është i gabuar sepse nga aktet, rezulton që çështja është hetuar dhe dërguar për gjykim nga vetë drejtuesi i prokurorisë. Ai nuk ka zëvendësuar një prokuror të thjeshtë që mund të kishte hetuar çështjen me një prokuror tjetër. As vetë drejtuesi i prokurorisë nuk ka qenë në kushtet e zëvendësimit sipas neneve 26 dhe 27 të K.Pr.Penale, përndryshe duhet të vendoste Prokurori i Përgjithshëm lidhur me zëvendësimin e tij. Në analizë të këtij shkaku ankimi, Kolegjit i rezultoi si më poshtë.

35.1 Nga aktet e administruara në fashikullin penal, referohet se në datën 21.03.2006, nga shërbimi i policisë kufitare të Kosovës, është marrë informacion se në pjesën e sipërme të pikës doganore Morinë, disa persona po kalonin mallra kontrabandë, konkretisht 16 krerë viça, dhe se më pas është bërë kapja dhe sekuestrimi i tyre. Në datën 22.03.2006, në mjediset e Komisarariatit të Policisë Kukës, është paraqitur vetë shtetasi M. K., duke deklaruar se viçat ishin të tij pasi i kishte blerë. Policia Gjyqësore pranë Komisarariatit Kukës, në datën 22.03.2006, ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit M. K., për atribuimin e veprës penale “kontrabandë”, të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal. Nga dokumentacioni i këtij fashikulli penal, rezulton se kjo çështje është referuar nga Policia Gjyqësore e Qarkut Kukës në datën 23.03.2006 në ngarkim të këtij shtetasi. Po në të njëjtën datë, është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. {***} ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, duke u caktuar edhe prokurori për hetimin e këtij procedimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. {***}, datë 25.03.2006, ka vendosur “arrest në burg” për këtë të pandehur, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Në datën 29.03.2006, çështja penale është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në ngarkim të këtij të pandehuri, për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal. Në datën 29.03.2006, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. {***} në ngarkim të këtij të pandehuri, për veprën penale të sipërcituar. Në përfundim të gjykimit, gjykata, me vendimin nr. {***}, datë 3.4.2006, ka vendosur: “deklarimin fajtor të këtij të pandehuri, për kryerjen e veprës penale të kontrabandës”, të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, e ka dënuar atë me 240.000 lekë gjobë dhe, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, përfundimisht i pandehuri është dënuar me 160.000 lekë gjobë. Sipas akteve të administruara në fashikullin hetimor të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit kishte nisur veprimet në këtë proces vetëm me depozitimin e konkluzioneve përfundimtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në datën 03.04.2006.

35.2 Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e datës 05.06.2009 të rezultateve të hetimit nr. 2, ka shpjeguar se: [...] nga verifikimi i dosjes nga ana ime, më rezulton se nuk kam qenë i ngarkuar me hetimin e çështjes, ajo është hetuar nga drejtuesi i prokurorisë, dhe është dërguar në gjyq me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë. Kërkesa dhe vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq, është bërë nga ish-drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Më rezulton se unë kam përfaqësuar akuzën, vetëm në një seancë gjyqësore, datë 03.04.2006, kur është shqyrtuar çështja me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë. Sigurisht, në seancë gjyqësore kam marrë pjesë me autorizimin e drejtuesit të prokurorisë, pasi nuk ishte çështje e hetuar nga ana

ime. Përfaqësimi i akuzës dhe kërkimet në llojin e masës së dënimit për të pandehurin në fjalë, janë bërë me autorizim dhe, pasi është marrë mendimi apo vendimi nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, qoftë i dhënë me gojë, qoftë me shkrim, sipas funksionimit në mënyrë të centralizuar të organit të prokurorisë në atë kohë. Akti për verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe standardeve procedurale, merret dhe administrohet në fazën e hetimeve paraprake, pa u dërguar çështja në gjykatë.

35.3 Kolegji vëren se në dosjen e administruar nga Komisioni për këtë procedim penal, nuk rezulton të ketë akt zëvendësimi, i cili të konfirmonte autorizimin për vazhdimin e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit, duke zëvendësuar kështu dhe prokurorin e mëparshëm që ka kryer veprimet hetimore për këtë çështje. Komisioni, në kuadër të një hetimi administrativ të gjithanshëm dhe të thelluar, duhet të kishte administruar dosjen gjyqësore nga gjykata ku është zhvilluar gjykimi i kësaj çështjeje, për të verifikuar në këtë rast se si është pasqyruar në procesverbalet e seancës gjyqësore zëvendësimi i prokurorit të çështjes me subjektin e rivlerësimit.

36. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të penalizohet për zbatim të ligjit, por për moszbatim të tij. Kërkimi i dënimit me gjobë për të pandehurin në çështjen e vitit 2006, megjithëse është i ligjshëm, nuk është bërë privatisht, por pas konsultës paraprake me drejtuesin e prokurorisë, në zbatim të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilin vetë trupi gjykues e citon në vendim. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit se ai ka vepruar në kundërshtim me nenin 484 të K.Pr.Penale, është i gabuar dhe duhet të rrëzohet nga Kolegji sepse, siç theksohet edhe në vendimin e Komisionit, çështja nuk është hetuar dhe dërguar për gjykim nga ana e tij, por nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, i cili duhet të kërkonte dhe të administronte vërtetimin e gjendjes gjyqësore për të pandehurin gjatë hetimit të procedimit. Në analizë të këtij shkakut ankimi, rezultoi si më poshtë.

36.1 Kolegji vëren se masa e dënimit kërkohet nga prokurori në diskutimet përfundimtare të çështjes dhe vendoset nga gjykata përfundimisht duke respektuar marzhet e dënimit që parashikohen për çdo vepër apo kundërvajtje penale. Kërkimi i masës së dënimit është diskrecion i prokurorit, i cili lidhet me një sërë faktorësh në kryerjen e veprimeve hetimore dhe rezultateve të hetimit. Në konkluzionet përfundimtare, të cilat janë firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, kishte parashtruar se: *Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit, mendoj të kihen parasysh: përhapja e kësaj vepre në vendin tonë; rrezikshmëria e saj shoqërore; sanksioni që parashikon dispozita përkatëse; rrethanat në të cilat është kryer; faktin se parashikohet si krim ekonomik, rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, si dhe rrethana të tjera që i çmon vetë gjykata. Mbi këto konkluzione, subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar: Deklarimin fajtor të këtij të pandehuri për kryerjen e veprës penale të lartpërmendur, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal dhe, po në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me 250.000 lekë, si dhe kalimin e vlerës së mallit të sekuestruar me procesverbalin, datë 22.03.2006, në shumën prej 308.400,14 lekësh, në favor të shtetit.*

36.2 Kolegji vëren se Komisioni i ka kërkuar informacion Zyrës së Regjistrimit Gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë, nëse i dënuari ka qenë edhe më parë i dënuar. Sektori i Gjendjes Gjyqësore ka informuar Komisionin se ky shtetas ka qenë i dënuar më parë me vendimin nr. {***}, datë 17.03.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprën penale të kontrabandës, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, dhe është dënuar me 1 vit burgim për këtë vepër penale. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte verifikuar gjendjen gjyqësore të të pandehurit duke ndërmarrë hapa kërkimorë pranë institucioneve kompetente, aq më tepër që personi i akuzuar, në kohën e

grykimit, rezultonte të ishte dënuar një vit më parë nga e njëjta gjykatë, ajo e Kukësit, në prokurorinë pranë së cilës ushtronte funksionin e prokurorit edhe subjekti i rivlerësimit dhe tek e cila mund të ishte edhe më e thjeshtë nxjerrja e të dhënave pa pritur dëshminë e penalitetit, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, se ishte veprim hetimor të cilin duhej ta ndërmernte prokurori tjetër që ka hetuar çështjen.

36.3 Kolegji vëren se sipas nenit 378 të K.Pr.Penale, pas marrjes së provave, prokurori, mbrojtësi i të pandehurit dhe përfaqësuesit e palëve të tjera formulojnë dhe parashtrajnë konkluzionet përkatëse të diskutimit përfundimtar. Në nenin 47 të Kodit Penal, parashikohet mënyra e caktimit të dënimit nga gjykata, ku në caktimin e dënimit ndaj personit, ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Rrethanat rënduese renditen në nenin 50 të Kodit Penal, ku ndër të tjera shkronja “ç” e këtij neni parashikon si rrethanë rënduese kryerjen e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë. Nga sa u parashtrua më lart, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë prezente në diskutimet përfundimtare të dorëzuara prej tij në gjykatë lidhur me këtë procedim penal, rrethanën rënduese të të akuzuarit, i cili rezultoi të ishte recidiv/përsëritës, pasi ishte dënuar vetëm një vit më parë për të njëjtën vepër penale nga e njëjta gjykatë. Në këtë mënyrë, është mundësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit një orientim i gjykatës drejt caktimit të dënimit pa e vënë në dijeni për recidivitetin e të akuzuarit, duke i mundësuar kështu edhe atij një dënim më të favorshëm nga ai që i takonte sikur të ishte bërë prezente edhe rrethana rënduese e sipërcituar.

36.4 Në përfundim të analizës, Kolegji vëren se lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë prezent një rrethanë rënduese, duke demonstruar mangësi në njohuritë ligjore, në përputhje me nenin 73²⁷, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

- 37. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2010**, në ngarkim të personit nën hetim I. H., i dyshuar për veprën penale të "Tregtimit dhe transportimit të mallrave që janë kontrabandë", parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vlerësimi i Komisionit se ai në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv, në përputhje me pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, është tërësisht i pabazuar në ligj, i paragjykuar, pa asnjë bazë, vetëm me hamendësime. Subjekti i rivlerësimit thekson se nga provat e grumbulluara për atë procedim, nuk mund të dilej në përfundimin se ishte kryer vepra penale. Vendimi është marrë pas një hetimi të plotë të çështjes, nga ku nuk është provuar se malli i sekuestruar i personit nën hetim, ishte me origjinë kontrabande, ashtu sikurse është arsyetuar në vendim. Në analizë të këtij shkakut ankimi, rezultoi si më poshtë.

37.1 Procedimi penal është regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës më datë 16.03.2010. Lidhur me rrethanat e çështjes, është konstatuar se rreth orës 02:30 të kësaj date, Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës, në vendin e quajtur {***}, ka ndaluar, kontrolluar e më pas shoqëruar në ambientet e policisë automjetin tip Benz Kamion me targë {***}, në pronësi të të akuzuarit, i cili drejtohej nga shtetasi A.M. Dyshohej se me këtë automjet po transportoheshin

²⁷ Neni 73, pika 2, "Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të fillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën".

mallra kontrabandë (disa materiale hekuri skrap dhe disa kuti) nga Kosova për Shqipëri dhe po transportoheshin drejt Tiranës. Me procesverbalin e datës 16.03.2010, është dokumentuar këqyrja dhe marrja e provës materiale, automjeti i lartpërmendur, 400 kuti kartoni me mbishkrimin INCANDESCENT LAMPS, me llamba elektrike 100 copë secila. Në relacionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”) pasqyrohet fakti se Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Kukës, me shkresën nr. {***}, datë 02.04.2010, ka konfirmuar se shtetasi I.H. ka kaluar në pikën e kalimit kufitar Morinë vetëm me autoveturë dhe furgon dhe nuk rezulton të ketë kaluar me kamion me targë {***}. Në referimin e veprës penale nga OPGj-ja, datë 16.03.2010, pasqyrohet se shtetasi I. H. ka deklaruar se “mallin e ka blerë ka tre muaj [...] nuk më kanë dhënë faturë tatimore me tatim mbi vlerën e shtuar”. Ky fakt pasqyrohet edhe në procesverbalin e marrjes së të dhënave të akuzuarit. Në procesverbalin e datës 16.03.2010, ora 17:00, me të cilin është marrë në pyetje i arrestuari, ai ndër të tjera është shprehur se ka qenë i pajisur me fatura tatimore, por kur ka kontrolluar në dyqan, nuk i ka gjetur dhe se nuk mbante mend se ku i kishte lënë. Më datë 29.04.2010, subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal {***}, duke konkluduar se nuk vërtetohet se mallrat e sekuestruara të jenë me origjinë kontrabandë.

37.2 Meqenëse Komisioni ka konstatuar disa mangësi në veprimet hetimore, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, i cili në shpjegimet e rezultateve të hetimit nr. 2, ka shpjeguar se: *Dy qëndrime të ndryshme të organit verifikues, brenda një harku kohor prej një viti e një muaj, është absurd dhe i pakuptimtë. Këto konstatime janë abuzive, denigruese dhe fyese për mua dhe për familjen time, ndoshta, edhe të qëllimshme. Nuk jam përfshirë në asnjë veprimtari të paligjshme. Çështjen e vitit 2006 e trajtova edhe më sipër, ku sqarova se si i është dhënë zgjidhja ligjore. Fakti se personi i akuzuar është dënuar me gjobë dhe jo me burgim, nuk do të thotë aspak se jam përfshirë në veprime korruptuese. Është e turpshme të thuhet një gjë e tillë, kur nuk ekziston asnjë e dhënë lidhur me këtë fakt të fabrikuar. Ligji i kohës parashikonte edhe dënimin me gjobë [...]. Thuhet apo raportohet se gjatë vitit 2010, dyshohet të jem përfshirë në një rast korrupsioni, duke orientuar personin e pandehur për kryerjen e veprimeve të caktuara, me qëllim ndryshimin ose lehtësimin e akuzës ndaj tij [...]. E theksova edhe më sipër se çështja është zgjidhur mbi bazën e provave dhe të ligjit [...]. Nuk kam favorizuar asnjë person për shkak të detyrës, por e kam përmbushur atë më së miri, përgjatë 21 vjetëve punë të ndershme e të përkushtuar [...].*

37.3 Kolegji vëren se në dosjen e administruar nga Komisioni në lidhje me këtë procedim penal, hetimi nuk ishte kryer i plotë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk ishin mbledhur të gjitha provat për qartësimin e rrethanave të akuzës së ngritur. Nuk rezultoi të ishte ndërmarrë asnjë veprim hetimor nga subjekti i rivlerësimit lidhur me deklaratimet e njëpasnjëshme kontradiktore, brenda një dite të të arrestuarit për faturat tatimore të mallit, i cili ka deklaruar se ka qenë i pajisur me fatura tatimore, por kur ka kontrolluar në dyqan nuk i ka gjetur dhe se nuk mbante mend se ku i kishte lënë. Këto deklarime kontradiktore të të arrestuarit janë indicie për të hetuar më tej nga ana e prokurorit për të qartësuar rrethanat dhe jo për t’u mjaftuar me deklaratimet e tij. Gjithashtu rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit nuk ishin kryer veprime hetimore ndaj firmës private prej së cilës ishin lëshuar faturat tatimore, për t’u siguruar në lidhje me vërtetësinë e deklaratimeve të të arrestuarit si dhe origjinën e mallit, nëse ishte apo jo kontrabandë.

37.4 Kolegji vëren mangësi në veprimet hetimore lidhur me faktin se nga korrespondenca me Degën e Doganës së Morinës, Kukës, ishte konfirmuar se shtetasi I. H. nuk i kishte zhdoganuar ato mallra, më pas nuk është hetuar nëse mallrat e tregtuara nga firma private ishin të zhdoganuara apo të blera nga një tjetër biznes, firma “{***}”, siç pretendon në deklaratimet e marra më datë

19.04.2010 përfaqësuesi i kësaj firme L. A., si dhe nëse ky biznes tregtonte mallra të kësaj natyre. Gjithashtu rezultoi në dosje shkresë e Drejtorisë së Tatimeve Kukës, e cila konfirmon se shtetasi I. H. është subjekti i regjistruar pranë kësaj drejtorie dhe nuk ka detyrime të papaguara, por nuk rezultoi në dosjen e procedimit penal ndonjë korrespondencë me institucionin tatimor për të vërtetuar nëse këto fatura të lëshuara për mallin ishin të regjistruara dhe të deklaruara në sistemin tatimor, për të arritur kështu qartësimin e situatës faktike se ato mallra nuk ishin objekt kontrabande.

*37.5 Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me procedimin penal me nr. {***} të vitit 2010, Kolegji arrin në përfundimin se në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.*

38. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në tërësi, megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
39. Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.
40. Kolegji, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni dhe në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në përfundimet e mëposhtme.

40.1 Për vlerësimin e pasurisë. Në përfundim analizës së shkaqeve të ankimit për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 55,25 m², ndodhur Kukës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e kryera deri në vitin 1999, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

40.2 Lidhur me analizën financiare të viteve 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e kryera në këto vite, në kuptim të neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 160, datë 14.06.2019, duhet lënë në fuqi, pasi gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, etikës si dhe vlerësimin tërësor të procedurave sa u përket praktikave:

40.3 Lidhur me aktmarrëveshjen për premtim shitjeje të pasurisë së paluajtshme apartament banimi 1+1, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të palës kontraktore shumë prej 28.000 eurosh, duke mos e deklaruar këtë fakt në deklaratën periodike të vitit 2006 e në vijim.

40.4 Procedimi penal me nr. {***}, i vitit 2015, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për pushimin e çështjes penale, tek i cili konstatohen mangësi në drejtim të qartësimin të pjesës arsytuese të vendimit, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

40.5 Procedimi penal me nr. {***}, i vitit 2015, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për pushimin e çështjes penale, tek i cili konstatohen mangësi në drejtim të qartësimit të pjesës arsyetuese të vendimit, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

40.6 Procedimi penal me nr. {***}, i vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë prezente një rrethanë rënduese, duke demonstruar mangësi në njohuritë ligjore, në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

40.7 Procedimi penal me nr. {***}, i vitit 2010, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

40.8 Në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë këto praktika të procedimeve penale, si dhe mosdeklarimi i aktmarrëveshjes për premtim shitjeje të apartamentit 1+1, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në zbatim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 160, datë 14.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.12.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi